

INTERVISTË ME SEDA PUMPYANSKAYA

New York | Data: 3 tetor, 2017

Kohëzgjatja: 102 minuta

Të pranishëm:

1. Seda Pumpyanskaya (E intervistuar)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja)
3. Lura Limani (Intervistuesja/ Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Seda Pumpyanskaya: Unë quhem Seda. Mbiemrin e kam pakëz të gjatë, Pumpyanskaya. Vështirë të theksohet. Jam lindur më 1965 në Moskë, dhe kam shumë kujtime. Kujtime të një jete të çuditshme por të lumtur në Rusi. Kujtime prej kur kam qenë dhjetë vjeç dhe kam ardhur për të jetuar në New York, gjë që më ka ndryshuar tërësisht perspektivën, sepse papritmas kisha ndjenjën e lirisë, ndjenjën e zgjedhjes. Dhe kjo është diçka që nuk do të mund të largohej nga unë kurrë, edhe kur u kthyem në Rusi. Kështu që, mendoj se prej atëherë gjithmonë kam menduar se bota është një, se nuk ekzistojnë ndalesa për të udhëtuar apo për të qenë kudo, dhe e gjithë jeta ime dhe karriera ka qenë krejtësisht ndërkombëtare.

Anna Di Lellio: Pse keni ardhur në New York? Pse ka ardhur familja juaj në New York?

Seda Pumpyanskaya: Babai im ka qenë gazetar. Në fakt ai ka qenë me punë në Shtetet e Bashkuara. Ka shkruajtur për çështjet politike këtu. U dashurua në të. Kjo nuk ishte një histori e lehtë dashurie sepse ishte në të '70-tat, në mes të luftës së ftohtë, por si gazetar i sinqertë, ai dëshironte ta zbulonte Amerikën e vërtetë për rusët. Kështu që, ai shkruante shumë rreth Shteteve të Bashkuara, politikës, e cila ishte interesante në atë kohë. Gjëra si *Watergate*¹ apo Panterët e Zi [*Black Panthers*]², apo çfarëdo, shumë rreth letërsisë. Dhe ajo ishte si një erë e freskët apo çkado qoftë sepse rusët gjithashtu dëgjonin gjëra të tmerrshme rreth amerikanëve, dhe ai dëshironte t'i hapte ato faqe.

Anna Di Lellio: Ndhuni e lirë të flisni më shumë. Mos... kjo nuk është thjesht një...

¹ Skandal i *Watergate* filloi në mëngjesin e hershëm të 17 qeshorit, 1972, kur disa hajdut u arrestuan në zyrën e Komitetit Nacional Demokratik, me lokacion në kompleksin e ndërtesave në Watergate në Washington D.C. Kjo nuk ka qenë një plaçkë e zakonshme: hajdutët kanë qenë të lidhur me presidentin e Amerikës Richard Nixon dhe kampanjës së tij për rizgjedhjen e tij president, dhe ata ishin zënë duke vëzhguar telefona dhe duke vjedhur dokumente.

² *The Black Panthers*, poashtu të njohur si *Black Panther Party* [Partia e Panterëve të Zi], ka qenë një organizatë politike e themeluar më 1966 nga Huey Newton dhe Bobby Seale me qëllim të sfidimit të brutalitetit policor kundër komunitetit Afriko-Amerikan.

Seda Pumpyanskaya: Po, sepse...

Anna Di Lellio: ... pyetje-përgjigje...

Seda Pumpyanskaya: Po, në rregull.

Anna Di Lellio: Pra nëse keni kujtime edhe rreth New York-ut...

Seda Pumpyanskaya: Në rregull.

Anna Di Lellio: ...dhe rreth babait tuaj, në atë kohë.

Seda Pumpyanskaya: Nëse dëshironi që unë të flas më shumë, po, më tregoni... jam mësuar të jap intervista ku kërkohen përgjigje të shkurtëra...

Anna Di Lellio: Jo, jo.

Seda Pumpyanskaya: ... por nuk pritet që...

Anna Di Lellio: Jo, jo.

Seda Pumpyanskaya: Në rregull.

Anna Di Lellio: Duheni thjesht... ndihuni e lirë të flisni rreth kujtimeve tuaja nga New York-u, dhe nga babai Alexander i cili në të vërtetë ka punuar për... nëse keni ndonjë tregim për të na rrëfyer.

Seda Pumpyanskaya: Eh po, më pyetët rreth asaj që më kujtohet nga fëmijëria. Sigurisht më kujtohet Moska, por është e çuditshme sepse ishte një vend që kishte shumë kufizime në shumë gjëra, por gjithashtu shumë liri. Të paktën në shtëpinë tonë. Liri e fjalës, liri e humorit, liri e të kuptuarit të vërtetë të gjërave. Sepse mendoj se rrethi ynë familjar ishte intelektual. Gazetarë. Kishte shumë njerëz artistë që ishin cinikë ndaj regjimit dhe shumë të lirë në shpirt.

Çfarë më kujtohet nga New York-u? Më kujtohet... mendoj se si fëmijë dhjetë vjeçar që erdhi në Shtetet e Bashkuara, kishte shumë gjëra të ndryshme nga ajo që kishim dëgjuar. Sepse ne kishim dëgjuar se Amerika është një vend me shumë ndalesa ku ka shumë gjëra të tmerrshme. Më kujtohen ndjenjat fizike. Njëra është ardhja në Manhattan, tek Wall Street dhe praktikisht duke e pasur kokën lart duke shikuar rrokaqiejtë, koka e një vajze të vogël duke shikuar lart. Siç shikon {ngritë kokën lart}, kështu, diçka që duket e pafund. Dhe ti vazhdon ta rrotullosh kokën dhe kjo gjë nuk ndaon kurrë sepse ti kurrë nuk e arrin fundin e ndërtesës.

Nuk është thjesht ndjenjë fizike, por një ndjenjë e çuditshme e lirisë sepse, sepse kjo është e mundur. Ndërtimi i ndërtesave kaq të larta është e mundur. Dhe më kujtohet një lojë fëmijësh që ishte interesante. Isha duke ecur me nënën time në rrugët e Manhattan-it dhe po provoja të gjeja dy makina të barabarta sepse gjithçka ishte ndryshe. Tavani, ulëset apo forma, apo çkado tjetër. Nuk kishte dy

makina të barabarta në New York. Diçka duhej të ishte ndryshe. Dhe unë vija nga një shtet ku ekzistonin tri modele makinash dhe rreth katër ngjyra, e verdhë, e kuqe, e bardhë dhe e zezë.

Kështu që, ishte diçka e vështirë për t'u kuptuar, por gjithçka ishte zgjedhje. Dhe kjo është diçka që mendoj që e thithë bashkë me ajrin, dhe kur u kthyem në Rusi dhe u kthyem sepse babai im po shkruante shumë për Shtetet e Bashkuara dhe shumë histori të vërteta në të cilat ai ishte i interesuar. Por këto ishin kohët e Partisë Komuniste, kohë të propagandës. Dhe përfundimisht, ishte një konferencë ku sekretari i propagandës dëshironte t'i mësonte gazetarët, siç ndodhë rëndom, çfarë të shkruajnë e çfarë jo. Ai gjodhi një dele të zezë, dhe delja e zezë ishte babai im.

Sepse fjalimi i sekretarit të propagandës ishte, "Duhet të shkruani për lëvizjen e klasës punëtore dhe jo për vajzat e milionerëve". Ky ishte një artikull i shkruajtur për Patricia Hirst, një artikull i madh, tregim shumë interesant e të tjerë. Në atë kohë, kjo nënkuptonte disi fundin e karrierës prej gazetari sepse babai im nuk u lejua më kurrë të vijë në Shtetet e Bashkuara. Ai ishte ulur në një dhomë në Moskë kur ky fjalim u mbajt. Nëna ime pranoi një letër që thoshte se ajo duhej të paketohej dhe të kthehej. Sidoqoftë, ishte një gjë e vështirë dhe mendoj se marrëdhënia me Shtetet e Bashkuara qëndroi disi sikur... si të them... si një histori e ndaluar dashurie.

Por çfarë është interesante, unë isha dhjetë dhe njëmbëdhjetë vjeç dhe ndjenjat të cilat po i përshkruaj, liria dhe zgjedhja në nivel njerëzor, është diçka që futet në lëkurën tënde. Dhe pas asaj, kudo që jeton, disi nuk beson më në atë që dëgjon sepse ti e di se dëshiron thjesht të jesh e lirë dhe dëshiron të kesh zgjedhje në jetë. Kështu që, çkado që ka ndodhur në jetën time më pas, besoj është determinuar shumë nga ky shpirt New Yorko-Amerikan, apo ndjenja kur ti dëshiron të jesh e lirë.

Anna Di Lellio: Sa gjatë...

Seda Pumpyanskaya: Kemi jetuar atje...

Anna Di Lellio: Çfarë ndodhi kur u kthyet?

Seda Pumpyanskaya: Kemi jetuar atje... kemi jetuar këtu për nëntë muaj. Mirëpo supozohej se do të jetonim këtu për pesë vjet dhe disi po sistemoheshim. Po zgjidhnim një banesë... meqë ra fjala, edhe ky është një tregim i mirë sepse shumë rusë në atë fazë duhej të jetonin në një bllok të madh banesash në Riverdale, disi në banesa kolektive, apo sidoqoftë, në ndërtesa ruse. Por ne, si familje gazetarësh, familja ime mund të jetonte në një ndërtesë normale. Dhe ishte shumë mirë të jemi në një ndërtesë normale dhe të shohësh gjërat që ishin ndryshe. Isha mrekulluar, po shikoj këtu në këtë dhomë, isha e mrekulluar nga dollapet. Nërtesat ruse në atë fazë nuk kishin dollapë të ndërtuar brenda. Isha e mrekulluar me dy banjo, apo tri, nuk më kujtohet, sepse ndërtesat ruse kryesisht kishin vetëm nga një banjo. Kështu që, atje ende nuk ekzistone ky koncept. Sidoqoftë, ashensorët, garazhat, gjëra që janë interesante.

Kështu që, kur u kthyem në vitin 1976 për shkak të kësaj historie të ndaluar dashurie, ishte e vështirë. Në familje, ajo që prindërit e tu bëjnë dhe ajo që ka ndodhur ishte determinuese, ishte disi një dashuri e vështirë, jetë e vështirë, sepse babai im për shumë vite nuk publikonte dhe ishte praktikisht i ndaluar nga çfarëdo pune gazetarije, dhe me të vërtetë u kthye në një dele të zezë sepse kjo është një kohë kur shumë njerëz ndalen për të të përshëndetur e të tjerë. Dhe e dini, varet nëse je në pushtet apo nuk je, ishte disi viti më i lumtur i karrierës së tij profesionale, dhe të qenit korrespondent në New York, pastaj pas asaj erdhën kohë të vështira.

Natyrisht që m'u desh të shkoja në shkollë. Një nga shoqet e mia më të ngushta, kishte shumë pak shokë të mirë, një nga shoqet më të ngushta ishte një vajzë e cila vinte jo nga një situatë e ngjashme, por gjithashtu nga një jetë dhe punë ndërkombëtare nga Meksiko. Kështu që, më kujtohet se ne... ishte qesharake sepse kaluam shumë kohë duke ndarë kujtime, e dini, të jetës së ndryshme. Dhe disi duke i pritur ndryshime që erdhën më vonë në vitet e '80-ta. Shteti u hap dhe ne të dyja patëm mundësinë të zbulojmë dhe jetojmë jetë të tjera.

Anna Di Lellio: Dhe kur, ku keni shkuar në shkollë? Po mendoj, çfarë ka ndodhur më pas, pas shkollës së mesme, çfarë ka ndodhur?

Seda Pumpyanskaya: Pas shkollës së mesme, mirë, në Rusi janë dhjetë vjet, dhjetë vjet të shkollimit. Kështu që, dhjetë vjetët e shkollimit përfshijnë shkollën fillore, një lloj shkolle të mesme dhe universitetin. Kjo ishte një shkollë, shkolla e Moskës. Dhe gjithmonë, për shkak të këtij ekspozimi ndërkombëtar gjithmonë kam dashur të mësoj gjuhë ndërkombëtare, kështu që ajo ishte një shkollë anglisht-folëse, shumë e mirë sepse unë gjithashtu kisha lëndë në anglisht, kishim historinë e Anglisë, kishim letërsi angleze dhe amerikane. Kështu që, kishte një ekspozim të madh ndërkombëtar që vazhdoi edhe në shkollë.

Pas asaj u futa në Universitetin e Moskës, në vitin '82 dhe kisha zgjedhur në mes gazetarisë dhe filologjisë. Pas hezitimit të gjatë, kisha zgjedhur filologjinë dhe në atë kohë isha duke mësuar frengjisht, dhe pastaj vendosa të shkoj. Garsia Marquez ishte shumë i famshëm apo sidoqoftë, i popullarizuar, i famshëm nuk është fjala e duhur, në atë kohë, kështu që mendova se ishte koha për të mësuar kulturën latino-amerikano dhe franceze. Kështu profesioni im kryesor në unviersitet ishte Spanjishtja dhe Kultura Spanjolle. Kjo ishte nga viti '82 deri në '87, pesë vjet në universitet dhe mendoj se duhet të them se jam saktësisht gjenerata e ndryshimit, e thyerjes.

Për shkak të këtij vargu të sekretarive të Partisë Komuniste që ndodhi, se ato vdisnin njëra pas tjetrës, ishte viti '82- '83 dhe '84, Gërbaçovi erdhi në pushtet. Jemi duke folur për vitin e parë dhe të dytë të studimeve për mua. Dhe në terma praktikë, kjo nënkuptonte një gjë, unë u futa në universitet në një shtet dhe diplomova në një tjetër. Kur u futa në universitet, dhe siç iu tregova, kisha zgjedhur grupin e spanjishtes, më kujtohet që ajo nuk ishte mësuese aq e mirë por më kujtohet ora e parë e gjuhës

spanjolle dhe mësuesja jonë. Ajo hyri në dhomë dhe tha, “Në fakt nuk e di çfarë po kërkoni këtu sepse kurrë nuk do t’i vizitoni vendet spanjisht-folëse, kurrë nuk do të punësoheni në punë që lidhen me gjuhën spanjolle. Epo, supozoj se doni të mësoni spanjishten, por e dini, thjesht kuptojeni se është disi hobi juaj”.

Kjo ishte në vitin ‘82. Në ‘83 siç thashë gjërat filluan të ndryshojnë. Isha në vitin e dytë kur erdhi Gërbaçovi. Në vitin ‘85 fillova punën time të parë sepse kishte një festival rinor në Moskë dhe ne vajzat e fakultetit filologjik disi na ftuan për të punuar atje, për t’iu ndihmuar me gjuhë për një javë. Dhe kjo ishte në kujtimet e mia, ishte disi, ekzistonte një lidhje me këtë përvojën amerikane të para dhjetë vjetve, ‘75, sepse aty kishte njerëz shumë ndërkombëtar. Përfundova me latino-amerikanët, me argjentinasi. Papritmas ishte kjo *fiesta* [festë] fantastike, dhe të gjitha llojet e ndjenjave dhe ndërveprimeve apo gjërave që ishin tërësisht të ndryshme nga ajo që kisha parë.

Dhe praktikisht, nga viti ‘85 kishte shumë ndërkombëtarë që vinin dhe njerëzit që flisnin gjuhë kërkoheshin shumë. Ndryshe prej asaj që kishte thënë mësuesja jonë. Kështu që, domethënë kishte punë të vogla, për shembull në festivale ndërkombëtare, festivale filmi apo festivale belli, apo për shembull kam pasur një punë shumë qesharake që nuk do ta harroj kurrë, me një grup nga Bolivia. Ishin një ekip futbollit, një ekip adoleshentësh që kishin ardhur për të luajtur në Moskë nga La Paz. Djemtë ishin nga 14-15 vjeç, por në një traditë shumë latino-amerikane, ata vinin nga familje shumë të mira apo të pasura. Kishte plot të afërm që kishin udhëtuar me ta, nëna, baballarë, gjyshe, teze, dajë.

Dhe ishte një delegacion tepër i madh nga La Paz, nga Bolivia. Shumë larg. As që kisha dëgjuar më parë për Bolivinë. Ata do të vinin në Moskë për pesë apo gjashtë ditë, e dini, për t’i shoqëruar djemtë. Dhe duhej të punoja si përkthyes për ta, disi t’ua shpalosja vendin tim. Kështu që, pati shumë qejf dhe shumë ndryshime. Në atë kohë, kisha diplomuar në vitin ‘87, papritmas profesioni im ishte i kërkuar. Papritmas kishte shumë ekspozim ndërkombëtar dhe një shtet ndryshe po hapej. Por është saktësisht gjenerata e një thyerje. Jeton në një vend të izoluar deri në moshën njezetë e diçka, me përjashtim të përvojës sime amerikane e cila m’i hapi sytë dhe ndjenjat dhe kuptimin, dhe papritmas zgjohesh në një vend më të lirë ku shumë mundësi hapen. Dhe kështu karriera ime shkoi në këtë rrugë ndërkombëtare.

Siç iu thashë, fillova të punoj si përkthyes. Shumë shpejt, fillimisht kam menduar, në rregull nuk do të bëj atë që kanë bërë prindërit e mi. Dhe familja ime kryesisht përbëhet nga gazetarë dhe filmbërës, por shumë shpejt unë përfundova në gazetari. Dhe në fakt punova për një gazetë spanjolle, “El Pais” në Moskë. Dhe ky ishte një kapitull tjetër sepse këto kohë ishin skajshmërisht dinamike, ku gjërat filluan të ndryshojnë shpejt, shpejt, shpejt. Dhe praktikisht, kur mendoj për ato kohë, vitet e ‘80-ta dhe të ‘90-ta, ekziston një ndjenjë se në një dekadë ke jetuar ndoshta njëqind vjet të historisë. Dhe kjo mendoj se është paksa një ndjenjë që më vonë, në një shkallë dhe rrethana të tjera, më vonë unë shkova në Ballkan dhe disi isha e tërhequr për të punuar në ato vende në tranzicion sepse në rininë time unë kisha jetuar nëpër tranzicion.

Kam jetuar një tranzicion shumë të shpejt ku gjërat janë tërësisht ndryshe, kur... ato gjëra, në shumë vende dhe shtete të tjera që i njoh deri tani, për shembull në Evropë, ku gjërat janë stabile, gjërat nuk ndryshojnë shpesh. Dhe kjo e bën atë më interesant. Kështu që, më vonë karriera ime më solli në botë dhe vende në tranzicion, sepse mendoj se kjo është një prej gjërave më fascinuese. Kështu në të '90-tat, po punoja si gazetare në gazetën spanjolle dhe poashtu vazhdova të shkruaj për një numër të madh publikimesh ruse dhe vazhdova të punoj për një televizion. Eh po, siç thashë, pjesë e familjes time është prapavija në filmbërje sepse gjyshi im në fakt ishte njëri nga kameramanët e parë në Rusi, në Bashkimin Sovjetik.

Është një rrëfim shumë interesant, ai është hebre nga Shën Petersburgu i cili u dashurua me kinemanë në vitet e '20-ta. Shkoi në Odesa dhe përfundoi në Kaukaz duke bërë filma dhe duke punuar në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën gjeneratë me Dziga Vertov i cili është, siç e dini, njëri nga filmbërësit e filmave dokumentarë më të njohur. Dhe ai takoi gjyshen time e cila është armene, ajo ishte tetëmbëdhjetë vjeç. U dashuruan dhe kishin jetë të mrekullueshme në të '30-tat, praktikisht duke mos pasur shtëpi. U dashurua me kinemanë. Duke qenë afër Dziga Vertov dhe gruas së tij, duke udhëtuar dhe xhiruar, deri në kohën e luftës. Pastaj gjyshi im ishte kameraman i luftës. Dhe fatkeqësisht vdiq në dhjetor të vitit '44, pak para përfundimit të luftës pas rrëzimit të aeroplanit. Dhe gjyshja ime e cila qëndroi e vetme me babain tim i cili ishte katër vjeç, ajo ishte 28 vjeç, bëri një gjë të mrekullueshme.

Ajo i dedikoi jetën krijimit të filmit dokumentar. Ajo filloi të punonte si asistente e tij dhe u bë regjisore filmash. Dhe kështu, ata qëlluan të jenë në Moskë. Sidoqoftë, për ta prerë shkurt një rrëfim të gjatë, unë gjithmonë e admiroj atë gjeneratë, atë histori dashurie. Atë histori dashurie, dedikimin ndaj filmit dokumentar. Kështu që kur m'u ofrua mundësia për të punuar për një televizion, dhe pasi zhvillova një imazh në lidhje me fjalët, sepse gazetaria është për fjalët, unë gjithashtu u dashurova në atë gjë. Fillova të punoj për televizione të ndryshme dhe përfundova duke punuar për BBC në vitin '97 për të bërë një film për Mikhail Gërbaçovin. E dashurova një gjë të tillë. Aplikova për disa bursa në Shtete të Bashkuara, bursa për gazetarë. Fitova një bursë Nieman në Universitetin e Harvardit.

Kështu që, u ktheva në Moskë nga Londra për tri javë. U ripaketova dhe shkova në Shtetet e Bashkuara. Kalova një vit në Universitetin e Harvardit. Një vit të mrekullueshëm. Mendoja se në atë fazë kisha mendime të arta sepse e dashuroja krijimin e dokumentarëve dhe ishte e vetmja gjë që doja të bëja ishte dookumentari... Isha duke luftuar në Harvard për të filluar studimet në arte pamore, dhe pastaj shkova në shkollën e Bostonit për të studiuar filmin e të tjerë, e të tjerë. Por siç ndodhë nganjëherë, jeta ime ndryshoi tërësisht. Ndodhi që isha në New York pas Harvardit, dhe në fakt më kishin dërguar në Bosnjë si kryesuese e Informacionit Publik për Misionin e Kombeve të Bashkuara në Bosnjë.

Për të qenë e sinqertë, kisha shumë pak njohuri. Ishte viti '99. Kisha shumë pak njohuri për Kombet e Bashkuara. Kisha pak njohuri praktike për ish-Jugosllavinë. Mirë, isha gazetare por pak njohuri komunikimi në atë fazë. Kështu që, mendoja se ishte e çuditshme si unë isha disi kandidatja perfekte,

por mendoj se kjo dashuri për aventurë dhe tranzicione më bëri që ta pranoj punën. Dhe kështu në prill të vitit '99, zbarkova në Sarajevë, në Bosnjë. Dhe kështu filloi kapitulli i Ballkanit.

Lura Limani: Na trego rreth Bosnjës. Çkado?

Seda Pumpyanskaya: Na trego rreth Bosnjës. Eh po, Bosnja. Më kujtohet dita kur kam zbarkuar atje. Dhe përsëri çfarë ndodhi, sepse pas asaj ishte një varg gjërash ndërkombëtare që ndodhën në jetën time njëra pas tjetrës. Kështu që, siç thashë, fillimisht ishte Mbretëria e Bashkuar, BBC. Pastaj Universiteti i Harvardit, Bostoni. Pastaj u ktheva në Moskë, u ripaketova dhe më 12 ose 13 prill të vitit '99 fluturova për në Zagreb. Në atë fazë, aeroporti i Sarajevës nuk operonte ende. Kjo ishte pas luftës. Bosnja ishte shumë shpesh në lajme. Kështu që, më kujtohet ndjenja e parë. Dikush nga Kombet e Bashkuara ishte i supozuar të më merrte në Zagreb, i cili është qytet i mirë. Dhe pastaj ishte kjo ditë me shi, fantastike, e mrekullueshme, siç ndodhë në prill apo maj, sikur tani në New York, ishte... Kështu që, zbarkon në këtë qytet evropian të mirë, paqësor, mesatarisht të madh.

Dikush nga Kombet e Bashkuara me një makinë të bardhë më mori dhe u nisëm për në Sarajevë. Vozitja zgjati rreth pesë ose gjashtë orë, dhe mund ta imagjinoj... eh po, jo vajzë, një e re, isha 33-34 vjeç, siç thashë me shumë pak njohuri se çfarë në të vërtetë ishte ajo. Pas një ore vozitje, kur përfundon në Republika Srpska dhe vazhdon e sheh këtë peizazh të mrekullueshëm. Goditesh nga e gjelbërta dhe sheh shumë shtëpi me vrima të çuditshme. Dhe në fillim nuk mund ta kuptoja çfarë ishte, e dini, ndoshta është lloj i ndërtimit, ndoshta është lloj... dua të jem e sinqertë, në Rusi për shkak të mosmirëmbajtjes, shumë shtëpi janë të lëna pas dore, kështu që ndjenja e parë ishte që ti sheh shtëpi të lëna pas dore, për kushedi çfarë arsye.

Por pastaj sheh vrrima të rrumbullakëta në sasi të shumta dhe as që e kupton çfarë janë. Pastaj përfundimisht mendoj se kam pyetur dhe më kanë treguar se kishte ndodhur spastrim etnik. Sepse asnjë shtëpi në rrugën tonë nuk ishte e banuar. Kështu gjithçka që dukej paqësore në një fshat paqësor në një të gjelbër paqësore me atë diell dhe temperaturë fantastike, ishte rreth njëzetë gradë celsius. Dhe papritmas e kupton në lëkurën tënde se spastrimi etnik është diçka shumë praktike. Është diçka shtëpi pas shtëpie, secilën shtëpi, pa kaluar asnjë. Mendoj se kjo ishte përshtypja ime e parë mbi luftën, e kuptueshme, praktike, diçka që gati-gati mund ta prekësh.

Erdhëm në Sarajevë dhe mendoj se një gjë tjetër që të godet, tashmë fola për të gjelbrën por... do të kthehem më vonë tek Prishtina dhe Kosova, sepse në Kosovë, në Prishtinë nuk goditesh nga e gjelbra aspak, të jep një imazh krejtësisht tjetër. E gjelbra e errët e Ballkanit është e njëjta ndjenjë sikur kur zbarkon në aeroportin e Sarajevës, i cili është disi i rrethuar nga malet dhe papritmas shikon nga aeroplani dhe e sheh këtë, sheh malet e gjelbra. Është shumë e freskët, por e gjelbër e errët. Kështu që ekziston diçka, si të them, ekziston diçka e çuditshme se Ballkani i fuqishëm, është një vend i ndjenjave të forta dhe kjo e gjelbër disi e bën më të fortë.

Kur e pranova këtë punë në Kombet e Bashkuara... dhe për të qenë e sinqertë, ndoshta me të vërtetë isha kandidatja perfekte por kisha shumë pak përvojë në disa nga ato gjëra dhe hezitua për një kohë të gjatë, pastaj ishte ndjenja e aventurës që më bëri ta pranoj.... Mendova, në rregull, nëse me të vërtetë... do ta pranoj për tre muaj, sepse i kishin këto kontratat e shkurtëra dhe nëse nuk funksionon, nuk funksionon. Do të kthehem. Siç ndodhë në aventura të tilla të mëdha që i ndërmerrë njeriu në jetë. Në tre muaj, me të vërtetë nuk kupton shumë. Afërsisht pas gjashtë muajsh fillon të kuptosh gjërat dhe pas një viti papritmas e kupton që jeta jote ka ndryshuar tërësisht.

Dhe punon në një profesion tjetër, të pëlqejnë gjëra të tjera, bën gjëra të reja dhe jeton ndryshe. Kështu që, mendoj se kjo ishte dinamika. Cilat ishin imazhet tjera, të cilit qëndrim? Sepse kujtesa është e çuditshme pas një kohe, e dini, pas diskutimit rreth vitit '99, është gati njëzetë vjet më parë, kështu që kujtesa nganjëherë shlyen shumë gjëra të panevojshme dhe ekzistojnë disa si imazhe apo përvoja, zakonisht ato më të mirat, janë ato që qëndrojnë me ty.

Sarajeva ishte vend i mrekullueshëm. Është, unë vij nga Moska e cila ka dymbëdhjetë milionë... Sarajeva është qytet i vogël provincial me treqind mijë njerëz. Kurrë nuk kam jetuar në vende të tilla të vogla. Është interesante sepse është gati sikur një rrugë e gjatë kështu {shpjegon një vijë me duar} me një tramvaj i cili shkon, është rreth dymbëdhjetë kilometra dhe e rretuar me male në të dy anët. Natyra siç thashë është goxha, goxha, goxha e bukur për shkak të maleve rrethuese dhe papritmas ti e kupton që është shumë e lehtë të bëhet një luftë në vende të tilla sepse thjesht i vendos armët në male dhe është e lehtë për të rrethuar Sarajevën. Është prapë, është një imazh fizik që e sheh. Papritmas, kjo qytezë e vogël provinciale, por e rrethuar siç ishte për një kohë të gjatë.

Në atë kohë, meqë ishte disa vjet pas luftës, ishin 36 mijë trupa, trupa të NATO-s, dhe dymijë policë të Kombeve të Bashkuara. Kështuqë, kur flasim për sigurinë personale, epo mendoj se ne ishim goxha të sigurtë sepse kishte shumë... Po mendoj, është një ndërmarrje krejtësisht e paprecedent. Ishte poashtu, mendoj... mua më pëlqen letërsia, kam diplomuar në fakultetin e filologjisë dhe ishin dy romane, dy vepra letrare të cilat më sillëshin në kokë. Isha duke lexuar romanin e Ivo Andrić "Ditari i Travnikut" i cili është një roman fantastik që është shpërblyer me çmimin Nobel, e që flet për një vend të vogël, Travnik, në Bosnjë, ku është një botë e tërë politike.

Ngjarja ndodhë në vitet e '80-ta dhe është një fshat i vogël dhe praktikisht atje është një konsullatë austriake. Dhe kohët janë duke ndryshuar në Sarajevë, përfaqësuesit turk dhe ata francezë që vijnë. Dhe është një marrëdhënie fantastike, gjëra gjeopolitike që ndodhin në këtë fshat të vogël. Kjo është saktësisht ajo që kam ndjerë në Sarajevë sepse në një vend të vogël ishte e gjithë politika botërore. Ishin të gjitha organizatat ndërkombëtare, të gjitha shtetet dhe papritmas bëhesh një lloj prizmi për të parë gjërat praktike, pragmatike. Nuk janë teoritë që mësojnë se çfarë duhet të bësh, janë njerëzit dhe marrëdhëniet e tyre, është saktësisht imazhi letrar siç e quan Ivo Andrić, i cili gjendet në terma shumë praktik. Nuk e di.

Flet për NATO-n, flet për 36 mijë trupa dhe papritmas e shikon mënyrën se si NATO është organizuar politikisht, në ato kohë në Sarajevë dhe e sheh se NATO udhëhiqet nga një gazetar amerikan, jo një gjeneral, i cili ka dy zëvendës. Njëri duhet të jetë anglez dhe tjetri francez. Tradicionalisht janë anglezë dhe francezë. Ata janë karaktere krejtësisht të ndryshme dhe nuk mund ta durojnë njëri tjetrin, kështu që e gjitha bëhet tepër surreale. Në një skenë të vogël si teatër, duke pasur të gjitha politikat botërore dhe njerëz nga nacionalitete, shndërrohet në një gjë tepër interesante dhe të çuditshme.

Çështja ishte për të bërë politika të mira sepse çështja e Bosnjës në atë fazë ishte funksionimi i saj dhe çfarë të bëjmë me konfliktin. Kjo ishte pyetja e cila nuk kishte përgjigje. Nuk u ndalua për një kohë të gjatë derisa u ndalua nga Dejtoni. Por kur u ndalua, kishte shumë pasoja të fuqishme. Çfarë po bënte komuniteti ndërkombëtar në formimin e shtetit, e cila më vonë ndodhi në Kosovë. Ishte ky shtet me tri nacionalitete, me dy entitete, një fjalë e çuditshme. Kishte paqe relative dhe papritmas komuniteti ndërkombëtar dhe këta njerëz u desh të bënin gjithçka, sepse kishte situata praktike.

Situata e parë praktike: të tri kombet i pëlqejnë shumë simbolet, si njerëzit në Evropë. Kështu që, në makinat e tyre ata vendosnin... eh po, kishin dy alfabete, natyrisht... ata vendosnin simbole kombëtare. Kështu që praktikisht, kur një makinë vozitë, nga dy kilometra ose nga një kilometër mund ta dish se po vozitet nga një kroat, serb apo boshnjak. Kështu që, nuk kishte liri të lëvizjes sepse ata qëlloheshin. Çfarë mund të bësh në një situatë të tillë? Sepse nuk ka liri të lëvizjes. Po mendoj, është tepër e rrezikshme të dalësh... dhe po flasim për një shkallë shumë të vogël, po flasim për udhëtimet nga një fshat në një tjetër. Nuk po flasim për, nuk e di, distanca amerikane apo gjëra të tilla, udhëtime qindra kilometërshe, prapë po flasim për pesë kilometra.

Kalon nëpër një urë prej një fshati në një tjetër dhe mund të sulmohesh sepse mund të identifikohesh. Kështu që komuniteti ndërkombëtar duhej të mendonte rreth kësaj. Ishte një detyrë. Ata kishin një zgjidhje të mençur. Ishte shumë e vështirë me kulturën botërore, kulturën demokratike të dialogut dhe dëgjueshmërisë e të tjerë. E dini, gjërat duhet të vendoseshin por ishte e pamundur në këtë fazë të pajtohesh me boshnjakët dhe serbët. Ata nuk donin të pajtoheshin. Dhe pastaj kishte shumë ndryshime të... domethënë, kur isha në Fakultetin Filologjik, kishim një grup serbo-kroat që mësonte serbo-kroatisht por në atë fazë, ata mendonin se këto ishin tri gjuhë, pra serbisht, kroatisht dhe boshnjakisht.

Ndërkohë që sinqerisht, morfologjikisht gjuha nuk kishte dallime të veçanta por kishte pretendime dhe nganjëherë komuniteti ndërkombëtar duhet ta përkthenin një broshurë apo diçka për publikun në disa tri gjuhë. Kështu që, zgjidhja e mençur ishte, të cilën askush nuk e priti, dikujt iu kujtua.... Ata nuk mund të pajtoheshin për numrat e tabelave të makinave sepse kishin dy alfabete. Zakonisht janë disa shkronja dhe disa.... Zgjidhja e mençur ishte zgjedhja, praktikisht, përdorimi i numrave që janë të përbashkët dhe zgjedhja e shtatë shkronjave që janë të njëjta në alfabetin latin dhe atë çirilicë, si për shembull A, O. Dhe tabela e makinave e cila do të kishte tre numra, si për shembull 123 A 456.

Dhe ata nuk e prisnin një gjë të tillë sepse më nuk do të mund të debatnin për gjuhën dhe alfabetin e... përfundimisht u pranua. Po iu tregoj këtë shembull sepse është diçka që ndryshoi tërësisht jetën e asaj zone sepse njerëzit që nuk ishin të aftë të lëviznin përkundër 36 mijë trupave dhe gjithë këtij formacioni e të tjerë, e dini, më në fund patën mundësi të lëvizin. Dhe po e jap këtë shembull reth, për të thënë se nga teoria e ndërveprimit ndërkombëtar për ndalimin e dhunës, paqeruajtjen... kishte teori shumë interesante të praktikave të shtetformimit. Bosnja u bë shtet dhe papritmas nuk kishte para, nuk kishte flamur, nuk kishte himn, nuk kishte kufinj, nuk kishte aeroport, nuk kishte asgjë, që në historinë botërore evropiane e formon një shtet.

Dhe komuniteti ndërkombëtar i atjeshëm duhej të merrej me këto çështje. Një shembull tjetër do të ishte himni, prapë me çështjen e gjuhës ishte një debat i madh për atë që duhej bërë. Dhe më në fund një propozim që fitoi ishte ai me një himn vetëm me muzikë, pa fjalë. Kjo ishte një zgjidhje tjetër e mençur. Dhe prapë debate të mëdha... sepse është interesant sa të rëndësishme janë simbolet. Njeriu mendon për atë që është më e rëndësishme, nuk e di, flamuri apo vënia e kufijve të shtetit? Kufijtë janë më të rëndësishëm por flamuri është shumë, e dini, emocional dhe përceptime të tjera. Identiteti është shumë i rëndësishëm.

Kështu që ekzistonte një debat i madh rreth flamurit. Kështu flamuri boshnjak përfundoi me dy ngjyra goxha të pazakonshme, e verdhë dhe vjollcë, sepse të gjitha ngjyrat e tjera si e bardha, e kaltra dhe e kuqja e të tjerë, ishin në shqyrtim për t'u përdorur nga të tjerët, e të tjerë, e të tjerë, e të tjerë. Dhe e përmenda se ishin dy romane letrare të cilat më sillëshin në kokë, më duket për shkak të prapavijës sime filologjike. Mendoja shumë për këtë vend të vogël ku po ndodhte e gjithë politika botërore, ku ishte e gjithë vëmendja e botës dhe i cili tërheqë gjithë botën. Dhe është gjithçka, ju e dini në një karrocë të vogël me njerëz apo marrëdhënie njerëzore. Dhe po mendoja rreth një kopeje mesjetare budallenjsh. Sepse ky është imazhi i... ishte një përzierje e çuditshme e njerëzve. Dhe kjo përzierje e çuditshme e njerëzve nuk ishte...

Ata shiheshin në një mënyrë tjetër nga njerëzit vendas sepse, sepse nuk është e lehtë. Papritmas ke një fluks të njerëzve të ndryshëm, dhe disi ata njerëz të ndryshëm të diktojnë apo tregojnë ty për atë që duhet të bësh. Nuk mendoj se dikuj do t'i pëlqente një gjë e tillë (qeshë), në një mënyrë apo në një tjetër. Dhe këta njerëz të huaj, eh po ata janë të gjithë të ndryshëm, por ata vijnë e shkojnë. Sepse, kryesisht ata vijnë si në një mision për një periudhë të caktuar të kohës, nuk e di, dy ose tri vjet dhe pastaj ikin. Kështu që qartazi njerëzit që jetojnë atje fillojnë të flasin, eh po, ndoshta në mënyrë cinike iu qasen atyre, "Çfarë po bëjnë këta njerëz? Ata nuk do të rrijnë. Ata nuk do të rrijnë".

Dhe ishte një përzierje e çuditshme e njerëzve, për të qenë e sinqertë. Por pjesa e mirë ishte se kishte shumë njerëz, nuk e di, që ishin... më duket se gjithmonë është një përzierje e çuditshme e njerëzve në secilën organizatë të madhe. Janë njerëz që vijnë thjesht për të pasur punë. Janë njerëz që vijnë thjesht për të pasur rroga. Janë njerëz aventurierë. Ka njerëz që ndoshta janë të frustruar me diçka, diçka nuk ka funksionuar, nuk e di, janë divorcuar apo diçka e tillë... ata kanë nevojë të bëjnë diçka të

re. Ndoshta e mira është se kishte shumë njerëz idealist.

Dhe kjo është pjesa interesante sepse është marrëdhënia... ndoshta nuk është... e di se shumë njerëz do të mendojnë se është gati si kolonializim apo protektorat apo çkado. Ndjenja... mendoj se është e njëjta gjë që ka ndodhur me misionet në mbarë botën, kur shkon në një mision të caktuar. Nuk e di, në kohë mesjetare, kryqëzatat apo çkado. Jam e sigurtë se gjithmonë ka pasur një përzjerje të çuditshme të njerëzve. Pjesa e mirë ishte se kishte shumë njerëz me qasje idealiste, kjo është kryqëzata që e gjej në shekullin XXI, apo fundi i shekullit të demokracisë.

Janë çështje të caktuara dhe shqyrtime nga pikëvështrime të ndryshme, prapëseprapë është një përzjerje e çuditshme, por kishte shumë njerëz interesant. Si në çdo marrëdhënie që nënkupton marrjen dhe dhënjen dhe ndoshta ishte... po mendoj, natyrisht që merrë diçka nga përvoja yte por vjen për të dhënë. Dhe këta njerëz që erdhën për të dhënë jo vetëm profesionalizmin dhe njohurinë e tyre por edhe dedikimin e tyre të sinqertë për një vend. Mendoj se kjo është ajo që e bën këtë ndërveprim shumë interesant. Dhe ata njerëz në një mënyrë shumë pasionante, sepse të gjitha misionet janë pasionante, provonin të jipnin më të mirën nga ndjenjat, pasioni dhe njohuritë e tyre në këtë proces kontradiktor të ndërtimit të shtetit.

Pjesa e Dytë

Anna Di Lellio: A mund të na japësh një shembull të punës tënde në Bosnjë dhe poashtu të njerëzve me të cilët ke punuar? Diçka që mund të ketë qenë veçanërisht sfiduese apo diçka veçanërisht të suksesshme që ke bërë?

Seda Pumpyanskaya: Eh po, puna ime ishte gjithmonë në komunikim. Jam një ish-gazetare. Fusha që e dua, fusha e cila poashtu mendoj se në njëzetë apo tridhjetë vjetët e fundit ka kaluar nëpër ndryshime dinamike sepse gjithçka sillet rreth komunikimit dhe mënyrës se si e transmeton lajmin tek njerëzit. Kështu që, kur erdha kisha... E thirra kryesuesin e marrëdhënieve me publikun, zëdhënësin e Kombeve të Bashkuara. Kështu që, praktikisht më dërguan atje për të gjetur mënyra moderne për të komunikuar me njerëzit dhe botën. Përgjatë luftës, mendoj se mjetet kryesore të komunikimit ishin konferencat për shtyp, për arsye se praktikisht çfarë po ndodhte atje, kishte shumë incidente, kishte shumë lajme për NATO-n, Policia e Kombeve të Bashkuara që po merrej me incidentet.

Pastaj ka shumë informacion për botën në ditët e sotme, me të gjitha gjërat që po ndodhin në botë. Disa... e dini çdo ditë ka... kështu që, ishte disi ashtu. Kështu që m'u desh të zhvilloja tërë strategjinë e komunikimit me boshnjakë dhe me botën në mënyra të ndryshme. Dhe bëmë shumë gjëra të mira. Kisha rreth tridhjetë njerëz që punonin për mua. Ishin pesë ose gjashtë ndërkombëtarë nga vende të ndryshme si në Kombet e Bashkuara, dhe rreth njëzetë njerëz të rekrutuar nga vendi. Ishte shumë interesante të punoje me ta sepse ishin të hapur. Ata ishin ndoshta sikur unë kur iu tregova rreth përvojës në Shtetet e Bashkuara. Ishte një punë prestigjioze për ta. Dëshironin të mësonin nga

ndërkombëtarët. Iu pëlqente ajo që bënin. Ishin shumë dinamik dhe rriteshin shpejt.

Kështu që ishte mirë që në mision të punoje me njerëz nga atje. Njëra nga gjërat interesante, ne për shembull... eh po do t'iu jap shumë shembuj të ndryshëm. Ky tramvaj për të cilin iu tregova, Sarajeva është rrugë e gjatë dymbëdhjetë kilometërshe. Më kujtohet njëherë patëm vendosur të bëjmë një tramvaj të Kombeve të Bashkuara, kjo ide ishte shumë e mirë. Ishte një tramvaj i kaltër i Kombeve të Bashkuara që lëvizte çdo ditë. Ndoshta njerëzve iu pëlqente dhe e shfrytëzonin. Ne ishim misioni që krijoj një shembull tërësisht tjetër. Më kujtohet ne ishim të parët në Kombe të Bashkuara që krijuam një uebfaqe. Sot mund të duket qesharake por kështu ishte. Misioni i Kombeve të Bashkuara në atë kohë ende nuk kishte uebfaqe.

Në vitin 2000, kishim këtë ide. Gjetëm disa njerëz vendas dhe ky ishte misioni i parë i Kombeve të Bashkuara për të krijuar uebfaqen e parë të tij dhe për të komunikuar përmes saj. Ky është një shembull tërësisht tjetër. Pastaj ishte një shembull tjetër, për shembull Kofi Annan i cili ishte Sekretetar Gjeneral brilant, po vizitonte Sarajevën. Natyrisht, ishte emocion i madh. Dhe papritmas pranoj një thirrje në telefon, “E di çfarë? Do të kemi një ngjarje për marrëdhënie me publikun”. Dhe unë isha shumë e freskët por në fakt na duhej të organizonim lindjen e miliardës së gjashtë në Sarajevë. “Dhe jji e kujdeshme sepse duhet të jetë një fëmijë me etnicitet të përzier” (qeshë).

Kështu që, megjithatë unë e mora mbi vete ngjarjen për marrëdhënie me publikun, ata që i kuptojnë marrëdhëniet me publikun. Ishte një goxha marrëdhënie me publikun dhe një ndërmarrje goxha e madhe që kishte të bënte me spitalin... tash më kujtohet. Mendoj se ishte fëmija i parë i lindur pas mesnatës dhe duhej të ishte nga një çift i përzier, boshnjak dhe serb. Dhe pastaj e kuptova... në fakt më duket... mund të gaboj tani, por dikush si mbesa e njërit nga presidentët e atëhershëm të Bosnjës, e cila ishte vendosur në kuadër si infermiere. Dhe e të tjerë, e të tjerë. Shumë gjëra po ndodhnin. Ishte praktikisht një ngjarje botërore, fëmija i gjashtë miliardtë i lindur në Sarajevë.

Dhe pastaj ishte një tregim i trishtuar sepse natyrisht, po mendoj e trishtuar apo jo sepse kjo familje ishte në kontakt me mua për disa vjet, për shkak se e ke këtë ngjarje për marrëdhënie me publikun dhe pastaj natyrisht askush nuk merret me ty pas asaj. Askush disi, e dini, nuk të mbështet ty përjetë. Dhe pastaj... pritet se ata do të mbështeteshin përjetë nga Kombet e Bashkuara ose nuk e di... se do t'iu paguhej një pension apo diçka e tillë. Kështu që, sidoqoftë, mendoj se me këtë shembull, jeta.... Kam folur për Ivo Andrić... jeta në Sarajevë në atë kohë me këtë ambient tërësisht surreal ndërkombëtar, me një përzierje të pabesueshme të njerëzve. Por pastaj ishte disi ashtu çdo ditë, ngjarje të pabesueshme ndodhnin, e dini, si mozaik.

Ishte shumë interesant. Ishte një jetë e lumtur sepse, si ta them, nuk ishte, nuk ishte e përsosur por të paktën njerëzit nuk po e vrisnin njëri-tjetrin. Kështu që, mendoj, e dini, iu tregova rreth të gjelbrës dhe shtëpive me vrime e të tjerë, e të tjerë, ajo fazë, mbi sipërfaqe, mbahej goxha paqësore. Kishte një incident apo tjetër, por nuk kishte vrasje masive ose incidente masive, por mund të ndjeni se është një

ndjenjë sipërfaqësore sepse thellë në zemër natyrisht problemet... është e vështirë të tejkalohen probleme të tilla kur bëhen shumë të rrënjësura. Nuk është se të gjithë fillojnë të pëlqejnë njëri-tjetrin një ditë më pas, dhe filluan të duan njëri-tjetrin, të përqafohen, e të tjerë.

Ata mirëmbajnë një lloj të caktuar të paqes. Siç thashë, ishte shumë e vështirë të pajtohesh me diçka sepse të gjithë do të ishin të sjellshëm dhe nuk do të pajtoheshin mbi asgjë apo veçanërisht kur mendon për Mostarin. Një vend tjetër i cili tashmë duket tërësisht ndryshe, sepse më kujtohet në kohën kur ura ishte e shkatërruar dhe ishte një vend i shkatërruar. Pesë vjet më parë shkova atje dhe nuk mund t'iu besoja syve të mi sepse e pashë urën përplot me tregje turke dhe e dini, shumë turistë. Dhe nuk e kisha parë atë para luftës, por është goditëse. Është goditëse në një mënyrë, ti mund të shkoje nga një vend në një tjetër.

Por gjëja interesante është se kombinimi në këtë vend pakëz sipërfaqësisht paqësor, me një të gjelbër të mirë... ky është një imazh tjetër, po kthehem tek e gjelbra përsëri sepse erdha e freskët dhe nuk kisha ato përvoja të kohës së luftës e të tjerë, e të tjerë. Por pastaj na thanë, na thanë zyrtarisht në Kombet e Bashkuara, kolegët tanë na thanë, "Kurrë mos ec në të gjelbrën". Fillimisht nuk e kupton, po mendoj, çfarë do të thotë? Sepse kishte reth një milion bomba në të gjelbrën, po mendoj në male, kështu që rregulli ishte që kurrë... vozitë anës një rrugë por kurë nuk duhet të ndalosh apo të dalësh në ecje. Thjesht, kurrë mos shkel në të gjelbër.

Sepse ishte një ndërmarrje e madhe, e dini... u deshën shumë kohë, tre apo katër vjet për të minuar gjithë shtetin, por u desh një forcë e madhe për ta deminuar vendin, apo si thuhet, për t'i larguar minat nga atje. Dhe natyrisht, gjithë kohën sa ishim ne aty. Kështu që e gjitha të jep përshtypjen e fragjilitetit, fragjilitetit, e ke të gjelbrën, e shikon por nuk mund të ecësh në të. E ke paqen por kjo paqe është fragjile. Por gjithashtu të jepte një ndjenjë të një zhvillimi dinamik dhe një lloji të caktuar të lumturisë sepse nuk kishte luftë në atë fazë. Kishte përfunduar.

Anna Di Lellio: Në rregull, a mund të na tregoni vetëm pak për jetën tuaj në Sarajevë, shoqërinë tuaj?

Seda Pumpyanskaya: Eh po iu tregova tashmë për rrugën e gjatë në Sarajevë, për kodrat. Kështu që, natyrisht Sarajeva i ka pjesët e veta të ndryshme por ka një qendër historike e cila është me të vërtetë e mirë dhe e cila ka një përzierje të asaj që do të mund të quhej si pazar dhe vend turk, bash çarshija. Shumë xhami dhe shumë minare, një kishë katolike, një kishë ortodokse dhe e gjitha brenda një ecje dhjetë minutësh. Dhe kjo është ajo që e bën këtë shije të çuditshme unike dhe të pëlqyer nga shumë njerëz. Kështu që shpejt e zbulova një vend të mirë matanë kodrës dhe kisha një familje fantastike boshnjake, Fikreta. Ata kishin një shtëpi. Ishte menjëherë në qendër por në majë, në majë të kodrës.

Kështu që ata e morën me qira pjesën e lartë të shtëpisë në mënyrë që unë të mund të shkoja e të vija. Dhe gjëja më e mirë që kisha ishte terasa e madhe nga e cila mund t'i shihja të gjitha minaret dhe gjithë Sarajevën dhe ishte tepër mirë. Kështu që jeta ime atje, ose shoqëria ime, kisha lloje të

ndryshme të miqve. Siç thashë në Kombet e Bashkuara kishte lloje të ndryshme të ndërkombëtarëve. Kishte amerikanë, indianë, australianë. Kishte njerëz nga më të ndryshmit, boshnjakë, njerëz boshnjakë. Shpejt takova dy gazetarë që m'u rekomanduan nga disa shokë.

Për shembull kisha një shok në New York që kishte punuar për *Associated Press* që më tregoi. Kështu që, njëra ishte gazetarë që ishte atje, Aida Cirkez, e cila ishte kryesuese e *Associated Press* në Bosnjë, dhe një tjetër Duška Juričić e cila punonte për televizionin. Ato u bënë shoqe të miat shumë të ngushta. Është interesante sepse unë isha gjithashtu, eh po disa kolegë nga Kombet e Bashkuara sygjerman, meqë kisha ardhur në mes të prillit, njëra nga fundjavat e para, më duket se ishte një fundjavë e gjatë... koncept i çuditshëm, disi koncept evropian... ata thanë, "Pse nuk shkojmë në det?" Dhe më morën në det ku tashmë e zbulova bregdetin kroat. Në fakt duhen katër orë vozitje për të arritur në Dubrovnik nga Sarajeva. Dhe ky ishte një imazh tjetër interesant, sepse po flasim për vitin '99.

Ky ishte viti kur Beogradi po bombardohej, kur Kosova po ndodhte. Ne shkuam. De përsëri kjo e gjelbër dhe kjo fushë e mirë, dhe këto ura që ishin ndërtuar nga guri. Pastaj erdhëm tek ky det i mrekullueshëm dhe pamje e bregdetit kroat me ishuj, me bukuri. Deti... problemi i vetëm është... moti ishte perfekt, 25 gradë celsius, deti tashmë ishte në rregull, njëzetë gradë celsius... problemi i vetëm në atë kohë dukej të ishte një bombë nukleare apo diçka që ishte hedhur. Sepse nuk kishte asnjë njeri. Ishte herët në sezonë por me shumë gjasë të gjithë turistët... kishte vetëm pak turistë, jo sikur tani, por ata pak turistë që iu pëlqente të shkonin atje, për shkak të bombardimeve në Beograd të cilat nuk ishin edhe aq larg... e dini kur pranoni lajme të tilla në Itali apo diku tjetër, njerëzit thonë, "Jo, jo, nuk do të shkojmë në atë zonë".

Kështu që, në fillim nuk mund ta kuptoja sepse pashë kaq shumë bukuri të pabesueshme dhe asnjë njeri, e dini, me të vërtetë, sikur pas bombës nukleare. Por është mirë për shkak të kësaj, të këtij bregdeti, jam e dashuruar në atë bregdet dhe është një ndjenjë tërësisht tjetër nga Sarajeva por kohë pas kohe na pëlqente të shkonim. Dhe mendoj se prej ditës së parë në njërin anë e sheh luftën dhe e ndjen atë ndërsa në anën tjetër është paqe në sipërfaqe. Dhe shumë perime. Njerëzit pijnë kafe dhe diskutojnë. Këshu që kishte shumë kafene dhe shumë komunikim e shumë gjëra për të bërë. Kështu që jeta atje ishte shumë dinamike dhe interesante dhe gjithçka ishte për bërjen dhe vëzhgimin e gjërave. Dhe gjetja e rrugëve. Por ishte...

Dhe natyrisht minaret. Çdo herë që dilja nga ballkoni dhe provoja t'i numëroja minaret, kurrë nuk mund t'i numëroja. Nuk e di sa janë, 20, 25, më shumë. Kishte shumë xhami dhe shumë minare dhe natyrisht, atë gjë dëgjon. Por gjithashtu mund të dëgjoje këmbanat e kishës katolike dhe një kishë shumë të vogël ortodokse. Dhe shpresoj se do të mund ta ruajë këtë përzierje të mirë.

Anna Di Lellio: Dhe pastaj kur shkuan në... si shkuan në Kosovë?

Seda Pumpyanskaya: Si kam shkuar në Kosovë? Kam qëndruar në Sarajevë, në Bosnjë, po mendoj, vizitoja Republikën Srpska dhe disa zona të tjera të Bosnjës për dy vjet e tre muaj. Dhe po kërkoja për ndonjë ndryshim apo diçka tjetër. Dhe m'u ofrua një mundësi për të shkuar në Kosovë. Atëherë veçse kishin filluar njerëzit të shkojnë. Kështu që praktikisht, m'u ofrua një transfer. Dhe kjo ndodhi në vitin 2001, në fazat e hershme të Misionit të Kombeve të Bashkuara, jo më i hershmi. Tashmë ishte rendi i dytë. Kështu që mendoj se ishte diçka si 30 korrik, 2001. Dhe natyrisht kisha qenë duke menduar por më duket se këto dy vite, dy vite e gjysmë në Bosnjë kishin determinuar shumë... eh po, prapavija e njohurive tua gjithmonë e determinon mënyrën se si i sheh gjërat... kështu që ajo e determinoi shumë për atë si e pashë Kosovën.

Gjithmonë e kam parë Kosovën nga prizmi boshnjak ose ballkanas. Në çfarë kuptimi? Në terma praktikë sepse kisha qenë duke jetuar përvojën e një konflikti tjetër. Natyrisht, konfliktet kanë rethana por është gjithashtu konflikt. Tani kisha ardhur tek konflikti i dytë por me përvojën e asaj si kishte ndodhur, si ishin marrëdhëniet dhe çfarë mund të bëhej e çfarë jo. Dhe tashmë iu tregova si ishte e vështirë të negociohej apo të pajtoheshim me diçka në Bosnjë. Dhe së dytë, natyrisht isha duke jetuar, isha e rrethuar me njerëz dhe e pashë veten në fushën e komunikimit, e dini, përmes asaj që po bëhej për të rindërtuar shtetin pas luftës. Prapë në terma praktikë.

Dhe pastaj, natyrisht që shumë determinohet nga qëllimet e misioneve të Kombeve të Bashkuara. Nëse flasim rreth asaj, misioneve të Kombeve të Bashkuara, mandatet ishin krejtësisht të ndryshme. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Bosnjë po merrej me dy gjëra: policinë dhe drejtësinë. Ishte një shok i madh për mua kur erdha në Kosovë.... Në Bosnjë kishte organizata të tjera ndërkombëtare të cilat po merreshin me subjekte të tjera, kështu që detyrat ishin të ndara... por Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë ishte praktikisht qeveri. Kështu që, sa i përket përvojës, ishte shumë më e madhe. A dëshironi të vazhdoj (buzëqeshë)?

Anna Di Lellio: Sigurisht.

Seda Pumpyanskaya: Eh po mendoj që fillimisht nuk e di çfarë prisja. Kisha pak përvojë, dëgjoja diçka në lajme. Mendoj se s'më kujtohet por mendoj... po provoj të kujtohem për kur kam ardhur me aeroplan apo me makinë. Me siguri me aeroplan. Sidoqoftë, papritmas nuk më kujtohet mënyra se si kam ardhur. Përceptimi ishte ndryshe. Prisja të gjelbrën e Bosnjës, por nuk e pashë të gjelbrën e Bosnjës sespe Prishtina, vendi ku pata zbarkuar ishte kryesisht... më vonë udhëtova dhe pashë disa zona të tjera... por Prishtina, Prishtina nuk është e gjelbër.

Është një qytet me madhësinë e Sarajevës, por Sarajeva ishte shumë e gjatë dhe e rrethuar me male, Prishtina është disi e ulët e rrafshët, e rrafshët, vend i ulët i rrafshët. Në të vërtetë, jo... malet mund të shihen në largësi, por nuk janë afër. Eh po, të gjithë e dijnë se ai është vend sovjetik me ndërtesat e përhirëta të cilat i shohim në shumë vende sovjetike, kështu që nuk është aq mirë. Por mendoj se kishte shumë ndjenja fizike të cilat... të gjithë po flisnin për Hotel Grandin i cili ka këtë kornizë para

luftës, dhe pastaj Kombet e Bashkuara ishin aty. Gjatë luftës ky ishte një lloj vendi... sidoqoftë, tipik, tipik, me njëzetë e diçka kate, ndërtesë e përhirtë si shumë hotele të tjera, nuk e di, nëse shkon në Siberi, ose në ish Bashkimin Sovjetik, ose në Rusi, sheh shumë ndërtesa të tilla.

Çfarë ndodhi pastaj? Nuk e di çfarë prisni. Më duket se kisha ardhur nga një vend pak i gëzuar dhe i mirë, atmosfera boshnjake, sepse tashmë ishim vendosur atje, tashmë ishim duke jetuar atje. Jeta po vazhdonte në këtë vend të ri. Gjëja e parë që të godet, ndoshta këto nuk janë imazhet më të mira, është pluhuri. Sepse disi gjithçka në Kosovë ishte gjithmonë e mbuluar me pluhur. Në Moskë njëlloj për shkak të shiut dhe për shkak të klimës e tokës, ose për shkak të kushedi çka, atje nuk mund të jetosh me këpuçë të pastra. Është gjithmonë përplot me pluhur dhe baltë, apo diçka.

Por në Kosovë kishte pluhur të thatë. Dhe përgjatë kësaj periudhe në të cilën kam jetuar atje, kisha një ndjenjë se disi merja frymë pjesërisht, ose diçka e tillë sepse gjithmonë ishte e përhirtë dhe gjithmonë me pluhur. Poashtu shumë vranët. Më dukët se ishte disi më pak me diell sesa në vendet e tjera të Ballkanit. Ndjenja e dytë është zhurma, sepse jeton në zhurmë gjithë kohës për një arsye shumë të thjeshtë: nuk kishte rrymë elektrike, dhe nuk kishte plan të qartë. Por çfarë po provonte të bënte komuniteti ndërkombëtar që të paktën të kishte rrymë elektrike për dy orë dhe katër të tjera të mos kishte. Kështu që të gjithë kishin gjeneratorë. Kështu që nëse ke shumë shtëpi dhe tepër shumë gjeneratorë që punojnë pothuajse gjithë kohën, ti gjithmonë jeton në një zhurmë.

Nuk isha e sigurtë, sepse po vija si ruse dhe nuk isha shumë e sigurtë nëse Bosnja kishte një jetë aq të sigurtë. Por, e dini, mendoj se politikisht ndihesh ndryshe nga Bosnja ku gjithçka ishte shumë, shumë, shumë e vështirë, por të paktën komuniteti ndërkombëtar po jipte gjithë kontributin për të provuar t'i shtyjnë njerëzit të komunikojnë dhe punojnë së bashku, po mendoj boshnjakët, kroatët dhe serbët. Por mendoj se ndjenja e parë në Kosovë, sepse ky konflikt atje ishte zhvilluar përmes një muri. Është një mur të cilin komuniteti ndërkombëtar nuk mund ta tejkalojë. Dhe kjo politikisht ishte ndjenjë ndryshe. Sepse punon në rrethana shumë të vështira por disi mundohesh dhe këtu e kupton se është një mur dhe nuk mund të bësh asgjë. Po flas sinqerisht për marrëdhëniet e serbëve dhe shqiptarëve. Dhe kjo ka determinuar shumë prej punës politike.

Sidoqoftë, siguria, për t'u kthyer tek siguria. Nuk isha shumë e sigurtë si do të dukesh si ruse për shkak të të gjitha mendimeve të njëanshme, mendoja se shqiptarët do të thonë, "Në rregull, kjo është ruse, kjo është pro-serbe". Nuk isha e sigurtë nëse do të më mirëpresin, nëse do të jem e aftë të kryej punën time? Çfarë, çfarë... këto janë pyetjet që më silleshin në kokë, të cilat janë normale, njerëzore. Reagimi im ishte qesharak, sepse isha duke ndenjur në këmbë diku dhe nuk e di, ishte një rend i shkurtër, e ktheva kokën dhe një djalë ishte pas meje. Dhe e pyes, "A je duke ardhur edhe ti?" Ai tha, "Po," I thashë, "Ku do të rrih në Prishtinë?" Dhe i thashë, "Pse nuk jetojmë së bashku?" (qeshë) Nuk mendoja të jetojmë së bashku në asnjë mënyrë, por mendoj se ishte ana ime mbrojtëse, pse jo, nuk e di, çift me dikë...

Ajo ishte një ndjenjë shumë e mirë sepse u shndërrua në një komunitet shumë të papritur dhe do të flas për këtë komunitet ndërkombëtar në Kosovë. Djali, shoku im Antonio, ishte nga Brazili. Ai po punonte si IT me një uebfaqe që ishte në zhvillim e sipër. Iu tregova se në Bosnjë ishte uebfaqja e parë që kishim krijuar. Po, në fakt erdha në Kosovë për arsye se dikush që kisha takuar në Bosnjë, Simone Hezlik, i cili ishte zëdhënës ose Kryesues i Informacionit Publik të Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë i cili ishte zhvendosur atje dhe më thirri, dhe kështu ndodhi transferi. Harrova t’iu tregoj këtë gjë.

Kështu që u ktheva kah Antonio. Sidoqoftë, përfundua. Ai tha, “Po, pse jo, le ta ndajmë një banesë apo çfarëdo”. Dhe filluam të kërkojmë një banesë që dikush na e kishte rekomanduar dhe ai tha, “Po, disa djem po na rekomandojnë diçka”. Pastaj shkuam. Përfundua duke jetuar në një vend të mirë... Kam prapavijë spanjolle, në kuptimin e gjuhëve. Flas gjashtë gjuhë dhe kam studiuar shumë letërsi spanjolle. Kështu që përfundua me tre latino-amerikan dhe unë. Shumë qejf. Njëri ishte peruvian, tjetri kilian. Antonio ishte nga Brazili, dhe unë. Tani, pse është e rëndësishme? Dy gjëra: kur gjërat... eh po ka jetë edhe përtej punës... kështu që kur gjërat, kur gjërat e përbashkëta janë të vështira, gjërat e përbashkëta po mendoj, drita, uji, ngrohja dhe të gjitha këto gjëra ishin të vështira. Nuk kishte ujë, nuk kishte dritë shumicën e kohës.

Natyrisht, edhe Kombet e Bashkuara kishin gjenerator në zyrë. Kështu që dy gjëra ndodhin: bëhesh i afërt me njerëz. Fillimisht të gjithë keni pak mundësi... dhe çfarë do të bësh? Të dalësh për shëtitje në rrugët me pluhur? Të shkosh të gjesh një vend për të vrapuar apo për të bërë sport apo çfarëdo. Të lexosh libër me qiri është pak më e komplikuar. Sidoqoftë, afrohesh më shumë me njerëz. Filloni të ndihmoni njëri-tjetrin. Formoni një komunitet të mirë dhe bisedoni shumë dhe disi gjeni zgjidhje të mira dhe ndihmoni. Kështu që sidoqoftë, kam menduar se nuk ka qenë saktësisht çështja e sigurisë por disi, nuk e di, një mendim surreal, por përfundova në një grup shumë të mirë duke jetuar në një mënyrë të mirë.

Dhe ndihma ndaj njëri tjetrit e komuniteti i mirë mendoj se ishte një anë tjetër e të metave të Kosovës. Ne... çfarë bën kur nuk ke rrymë në frigorifer? Si do të mbash, nuk e di, ushqim apo çkado. Kështu që menduam një zgjidhje të mirë. Vendosëm që gjithmonë të kemi djathë dhe verë (qeshë). Të paktën ato nuk prishen kur frigoriferi të ndalet për katë orë. Kështu që në mbrëmje ne kishim shumë, si të quhen, ndeja, jo saktësisht ndeja por uleshim, bisedonim, komunikonim, tregonim rrëfime e të tjerë, thjesht me verë dhe djathë. Dhe kjo ishte një gjë e mirë.

Ishte gati, në terma të mirë, ishte si atmosfera në një kamp pionierësh apo diçka e tilë. Kur shkon në komunitet, është komunitet. Komuniteti mund të ketë gjëra të mira edhe të këqija siç e dijmë. Por komuniteti ndërkombëtar atje ishte më shumë komunitet sesa në vendet tjera. Dhe sigurisht, në një jetë shumë të organizuar disi njeriu ka tendenca të komunikojë më pak për arsye se ka gjëra për të bërë e të tjerë.

Lura Limani: Në rregull, çfarë për ata që i quajmë vendas? Komunikimi me vendasit?

Seda Pumpyanskaya: Komunikimi me vendasit. Si të them? Pra, unë kisha këtë çështjen e të qenit ruse. Është interesante, mendoj e gjithë bota është rreth racës, e të tjerë, kur e din se nuk shihesh ose nuk mund të shihesh, nuk e di, si e zezë, siriane, ruse apo serbe. Nuk e di, ka pak stigmë. Eh po, mendoj se për mua nuk ishte çështje jetë a vdekje. Po mendoj, në... është një gjë e çuditshme. Diçka që të determinon. Sepse mendoj që e gjithë bota ka tendencë të jetoja, ose unë kam një mendim tërësisht kosmopolitan. Me të vërtetë... për mua çështjet e dallimeve, të religjionit, nacionalitetit apo ngjyrës nuk duhet të kenë rëndësi. Përpos pasurisë së gjërave që ato mund të sjellin.

Por kam frikë se në botën moderne ka gjithmonë e më shumë stigmë, dhe njerëzit jo domosdoshmërisht, njerëzit kanë tendencë t'i shohin gjërat nga prizmi i tyre. Nuk mund të them, fillimisht unë kam pasur shumë miq shqiptarë. Ndoshta edhe kjo ka qenë e determinuar. Çfarë kam parë? Eh po, kur kthehesh në Prishtinë sheh shumë... pashë gjithë qytetin që ishte i mbushur me makina të bardha, makina të Kombeve të Bashkuara. I gjithë qyteti. Në Bosnjë nuk ishte njësoj. Shumë makina të bardha por jo të gjitha. Sepse atje jeta ishte ndryshe. Dhe atje ishte qeveria, kështu që ishte, ishte shumë.

Lura Limani: Makinat e bardha, makinat e Kombeve të Bashkuara?

Seda Pumpyanskaya: Makinat e bardha, makinat e Kombeve të Bashkuara. Më kujtohet kur erdha në Hotel Grand dhe çdo makinë ishte e bardhë, kështu që ishte... Gjithashtu pashë shumë shtëpi të cilat ishin në ndërtim e sipër dhe ishin shumë të mëdha. Kështu që ishin shtëpi, por shumë të mëdha. Ndoshta pesë ose gjashtë kate. Shtëpi private. Dhe më vonë e zbulova se shqiptarët ishin të orientuar kah familja dhe qëllimi ishte që babai të ndërtonte një shtëpi ku do të kishte një kat për secilin fëmijë, kështu që nëse familja kishte katër ose pesë ose gjashtë fëmijë, shtëpia do të kishte katër, pesë ose gjashtë kate. Dhe gjithashtu kati përdhese do të ishte dyqan për shkak të biznesit. Kështu që e gjithë Kosova ishte në ndërtim e sipër në atë kohë.

Kishte shumë shtëpi që po rriteshin me tre kate por të tjera që po ndërtoheshin. Kështu që... kishte, një ndjenjë që fillimisht... kishte shumë ndërkombëtarë, ndërveprimi im me më shumë ndërkombëtarë dhe shumë më shumë ngusht të familjeve në familje të mëdha, imazhi im janë ato shtëpi. Dhe më vonë, natyrisht përmes disa gazetarëve e të tjerë, fillova të bëj miq dhe të takoj njerëz. Kështu që, puna ime ishte, dhe mendoj se kjo e bën atë përvojë më interesante, apo më unike, ndoshta për shkak se isha ruse apo kushedi, në zyrën e shtypit detyra ime ishte të punoj me gazetarë serb.

Eh po është më e lehtë të thuhet sesa të bëhet sepse nuk kishte gazetarë serb në Kosovë. Asnjë (buzëqeshë). Kështu që, kështu që, në rregull, mirë shumë. Çfarë do të bëj? Por pastaj kjo ishte detyra politike sepse zgjedhjet po vinin dhe kishte diçka që komuniteti ndërkombëtar mendonte se ishte një plan, plan strategjik që quhej strategjia e angazhimit të serbëve. Një fjalë shumë perëndimore.

Lura Limani: Po flisni për zgjedhjet e para?

Seda Pumpyanskaya: Zgjedhjet e para.

Lura Limani: Në rregull.

Seda Pumpyanskaya: Për shkak se ekzistonte një ndjenjë se serbët nuk do të votojnë. Kështu që ishte një ide se çfarë mund të bënim që t'i inkurajonim serbët të votonin. Dhe kishte një kuptueshmëri se serbët në Kosovë do të votonin nëse ka ndonjë mesazh politik që vjen nga Beogradi. Por në mënyrë që mesazhet politike të vinin nga Beogradi, duhet media dhe komunikimi. Si do të ndodhë nëse ekziston një mur? Kështu që, me gjithë këto gjëra komplekse për të cilat po iu tregoj, praktikisht na u desh të punojmë me një gazetar serb. Le të gjejmë një gazetar serb. Po iu tregoj këtë... jo ishte fantastike. Ndoshta po iu tregoj gjëra komplekse por, por unë gjithashtu kisha... po mendoj, kam vizituar më shumë, jo vetëm Mitrovicën, por kam vizituar enklavat, manastiret, kam shkuar në Beograd, kështu që në një rrafsh më të gjerë kam qenë më shumë e ekspozuar ndaj pjesës serbe të tregimit gjatë asaj faze në Kosovë, e cila ishte goxha interesante. E vështirë, shumë e vështirë.

Si ka funksionuar? Kam shkuar në Beograd për arsye se gazetari serb ishte atje. Dhe kishim një ide të sillnim një grup gazetarësh serb në Kosovë. Këtë donim ta bënim dy vjet e gjysmë pas luftës. Po flasim për vjeshtën e vitit 2001. Formuam një grup prej trembëdhjetë gazetarësh. Dhe shkova nëpër gazeta e televizione serbe. Shkova për të takuar njerëz, shkova për t'i kërkuar. Ishte e çuditshme të shkosh në Beograd nga Kosova me makinë. Ishte shumë e çuditshme të shkosh nga Prishtina në një qytet të madh, sepse realisht qyteti i madh, kryeqyteti i Ballkanit verior është Beogradi. E vështirë të thuhet por është vend i mirë. Gjithashtu më kujtohet kjo ndjenjë e pluhurit dhe gjeneratorëve e gjerave të tjera... kjo është diçka shumë e sinqertë, kur unë ose dikush shkonte në Beograd, ëndrra e parë ishte arritja tek Hotel Hyatt, i cili ishte një hotel i mirë, dhe për të bërë banjë (qeshë).

Kështu që gjëja e parë që bënim ishte mbushnim vaskën dhe uleshim në të për rreth dy orë (qeshë) sepse, sepse ekzistonte një ndjenjë për të pastruar pluhurin. Por mendoj se ishte më shumë një ndjenjë esenciale, për shkak se konflikti ishte i shëmtuar. Ndjenja e pluhurit dhe baltës dhe shëmtia të cilën disi e merrje nga Prishtina me të gjitha gjërat, po kthehej në një imazh të konfliktit etnik. Dhe ti gjithmonë dëshiroje ta pastroje veten nga ajo. Dhe vazhdimisht dëshiroje të gjeje zgjidhje për atë por thellë në zemër e kuptoje që... që kishte dy anë të rrëfimit, [një] ishin kosovarët shumë të lumtur dhe dinamikë... kishte një flamur, flamuri amerikan ose ai kosovar në secilin cep.

Kishte shumë ndërtim, shumë dinamikë sepse mund ta ndieje lumturinë e pabesueshme dhe fatin e njerëzve që disi kishin marrë atë që kishin dashur. Dhe kishte ndjenjë tërësisht tjetër nga cilido vend ku kishte serbë, sepse kishte një ndjenjë të fundit të hidhur dhe të një zgjidhje jo të mirë. Dhe kjo është ajo që emocionalisht... nëse puna në Bosnjë, gjërat ishin të vështira edhe atje por atje disi kishte shpresë,

shpresë të cilën dikush mund ta humbë... Mendoj se puna ndërkombëtare dhe të gjitha gjërat e ndërtimet e duhura janë bërë në shtetin kosovar, por nuk ka pasur zgjidhje për çështjen e serbëve. Dhe këtë gjë e ndjenim të gjithë në atë kohë.

Tani për t'u kthyer tek gazetarët. Pra shkova për të folur me televizionin, erdha në qytet dhe natyrisht të gjithë po flisnin për bombardimet dhe amerikanët dhe disi dukeshin si një lunatike që vinte nga Kosova apo sidoqoftë. Por ishte, nuk e kuptoja sa e vështirë ishte. Për arsye se në televizion, po flasim për televizionin kryesor serb, dhe thashë, "Si mund t'iu ndihmoj?" Në fakt ata thanë, "A mund të na dërgosh një fotografi të Prishtinës?" Thashë, "Çfarë, çfarë doni të thoni?" Ata thanë, "Nuk kemi parë asnjë fotografi për dy vite". Kur vjen nga komunikimi, nga televizioni, kjo gjë është e keqe.

Me të vërtetë ata nuk kishin parë asnjë foto fizike. Dhe njëra nga punët që kisha filluar, duhej të organizoja, natyrisht uebfaqja u zhvillua në atë fazë, por duhet të organizoja shkëmbim të fotografive të thjeshta... nuk po flasim për intervista apo situata të caktuara, por thjesht fotografi të thjeshta, kështu që të paktën media serbe ta pranonte një gjë të tillë. Vizita në kërkim të një gazetari serb në Beograd, kuptimi se kishte një etje për informacion, uri... ata nuk kishin marrë kurrfarë informacioni për dy vjet. Kishin marrë përmes CNN apo... e cila është një rrugë shumë e gjatë. Kështu që, kështu e kuptonin ata se çfarë po ndodhte.

Pjesa e Tretë

Seda Pumpyanskaya: Kështu që, vendosëm të sjellim gazetarë të caktuar. Formuam një grup mjaft të mirë. Po kuptoja se ata po vinin me një uri të madhe, po mendoj uri për informacion. Por, nuk ishte e lehtë sepse edhe me një grup serb, për shembull i gjithë udhëtimi u desh të bëhej me makina të blinduara. Kishte makina të blinduara të Kombeve të Bashkuara të cilat i sheh ndonjëherë sepse kjo është mënyra si të tregosh se ka siguri. Nuk mund ta dinim se çfarë do të ndodhte, kush do të na ndihmonte. Mendoj se me një... në jetën time më pëlqen të hap dyer. Kështu që, rihpja e dyerve të informacionit për gazetarët serb në Kosovë, mendoj se ishte, mendoj se ishte një hap i mirë. Ishte një hap shumë i rëndësishëm.

Dhe më vonë praktikisht m'u desh të isha njeriu që ishte ulur në Kosovë në zyrën e informacionit të Kombeve të Bashkuara që mundahej t'iu siguronte informacion gazetarëve nga Beogradi apo gjithë gazetarëve nga Serbia. Qofshin ato fotografi, imazhe, intervista, nuk e di, qasje, apo gjëra të tjera. Tani, çfarë kemi parë për shembull ose çfarë kam parë dhe më vonë kur kemi shkuar? Çfarë ndodhi në Kosovë dhe kur flas për këtë luftë, shtetet e tyre janë enklavat. Çfarë është enklava? Enklava është një fshat i vogël për shembull dhjetë kilometra nga Prishtina, ku jetojnë 150 njerëz. Serbë. Për shembull je mu aty dhe e sheh makinën, natyrisht me një tabelë serbe por kjo makinë nuk mund të udhëtojë askund. E kuptoni... fare. Kemi folur tashmë për problemet e lëvizjes në Bosnjë, por këtu ishte edhe më keq.

Sheh njerëz që janë komplet të shkëputur, është gati si... të shkëputur nga gjithçka sepse nuk mund të dilnin prej fshatit. Ata mund të shkonin vetëm nëpër shtëpi. Nuk mund të dilnin jashtë për të blerë bukë. Natyrisht ata kishin trupa italian që i mbronin ata me uniformat dhe makinat e blinduara dhe ata po kërkonin nga trupat italiane që ata të shkonin në dyqanin shqiptar për t'iu blerë bukë dhe për t'ua sjellur atyre, me makina të blinduara. Përsëri, këto janë imazhe... po mednoj, natyrisht që je duke folur rreth asaj se si do të punosh? Si do të fitosh jetesën? Si do të marrësh pensionin kur je i shkëputur nga gjithçka.

Ky ishte një imazh trishtues sepse kjo është diçka që ti kryesisht... e vetmja gjë që mund të bësh është mbrojtja e këtyre njerëzve. Por kur flasim për çfarëdo lloji të integritit në jetë normale, çfarë do të bëni për një gjë të tillë? Kështu që, mendoj se e gjithë çështja e enklavave të jepte ndjenjën e një fundi të trishtuar dhe mungese të zgjidhjes. Tani gjërat e ngjashme që mund t'i shihje në manastire në jug. Dhe ka manastire të mrekullueshme serbe, dhe ato janë pjesë e rëndësishme e kulturës. Por prapë, mund ta shohësh një manastir, shtatë murgj dhe katër makina të blinduara, dhe trupa të KFOR-it e NATO-s duke i ruajtur ata. Dhe murgjit, të ulur brenda manastirit, duke mos pasur shumë mundësi për të dalë jashtë.

Është disi sikur papritmas je i rrethuar në banesën tënde dhe duhet të rrih ulur brenda. Sidoqoftë, për pak kohë mund të ulesh dhe t'i bësh gjërat por gjithashtu të nevojitet liri për të lëvizur për të bërë gjëra. Kjo ishte ndjenja e njerëzve atje. Dhe pastaj ishin çështjet e komplikuar të dy anëve të Mitrovicës, me një urë dhe gjithçka tjetër. Kishim shumë tregime të serbve të cilët ishin, si të them... edhe kur isha në Bosnjë, boshnjakët, kroatët dhe serbët... në një bisedë, "Kur do të dal nga kjo?"

Boshnjakët kanë shtet dhe gjithçka tjetër. Kroatët ishin shumë të palumtur sepse mendonin se ata nuk kishin shtet, sepse shteti ishte i ndarë në dy entitete dhe ata ishin të përzier, kështu që nuk kishin shtet, apo sidoqoftë... pavarësi, territor, çkado qoftë. Kështu që ndoshta kjo është arsyeja pse marrëdhëniet në Mostar janë shumë më të komplikuar. Serbët kanë diçka. Në rregull, ata kanë humbur një çfarëdo qoftë, perandori apo çfarëdo qoftë, por nuk kanë marrë shumë. Kështu që edhe më tutje në Kosovë, për arsye se natyrisht, kosovarët... dhe kishin një ndjenjë të lumturisë. Mendoj se kjo ishte kontradikta, kishte shumë lumturi në anën e kosovarëve sepse shumë gjëra kishin ndodhur. Dhe ishte periudhë tepër dinamike. Prishtina me të vërtetë dukej si një vend shumë i ri, shumë dinamik, shumë gjëra po ndodhnin.

Dhe papritmas ishte kjo ndjenjë e lumturisë së thellë në secilin vend. Më nuk kishte të bënte, apo kishte, apo kishte pak të bënte ose ndoshta aspak, e dini, ndoshta me Millosheviçin ose gjërat e mëparshme. Por me faktin se njerëzit në atë fazë nuk kishin marrë shumë, dhe anasjelltas, atyre iu ishte ndaluar çdo burim alternativ. Burime për jetë. Ishte më interesante sepse mendoj... përvoja në Kosovë ishte tërësisht e ndryshme nga ajo në Bosnjë. Eh po, siç thashë, ishte fushë e ndryshme, konflikt i ndryshëm. Mendoj se gjuha ishte faktor shtesë sepse meqë gjuha shqipe në Kosovë është në një grup tërësisht të ndryshëm të gjuhëve, prandaj gjithashtu ndihesha...

E dini, nëse dëgjon boshnjakishten, ti debaton nëse ajo është kroatisht apo çfarëdo, boshnjak ose serb, jo vetëm alfabeti, por edhe fjala për shembull, në kroatisht bukës i thonë *kruh* dhe *hleb* gati si rusisht... dhe ata po gërryenin këto fjalë që kishin origjina të ndryshme. Kështu që, shqipja dhe serbishtja natyrisht se janë dy grupe të ndryshme të gjuhëve dhe nuk kanë të bëjnë me njëra tjetrën, nuk është një ndërveprim i vetëm.

Kështu që ekzistonte kjo panoramë e Ballkanit, disi në formësim e sipër. Sepse shkon në Kroaci, shkon në Slloveni, kisha shkuar edhe atje për të shikuar dhe edhe atje kam parë këtë vend paqësor të gjelbër i cili fatkeqësisht, e dini.... Sidoqoftë, ishte vendi i parë më paqësor, e sheh Bosnjën krejtësisht të shkatërruar me katër milionë njerëz të zhvendosur, kështu që praktikisht dy nga katër milionë, praktikisht pesëdhjetë përqind dhe me këtë, si të them, përzierje kulturore. E sheh Kosovën me këtë zhvillim shumë dinamik, dhe shumë me fat për ta. Mendoj se ky tregim është tregim me fat. Dhe për të qenë e sigurtë nga perspektiva ime, ju do të ishit të aftë të kuptoni se shumë gjëra ishin të determinuara nga rrethanat.... Është kundër prapavijës boshnjake shpallja e pavarësisë.

Nuk e di, në disa rrethana të tjera ngjarja do të zhvillohej ndryshe, por këtu ishin të frikësuar nga përsëritja e disa gjërave të tjera të cilat nuk ishin parandaluar më herët ose nuk ishin parandaluar me kohë. Por ishte kjo çështje e madhe e fundit të trishtë për serbët në Kosovë e cila natyrisht më ndoqi mua sepse është e vërtetë. Kjo përvojë ishte e veçantë për arsye se mendoj në terma të ndjenjave profesionale, mendoj se kam qenë, e dini, disi përjeton përvoja të pjeshme në vende të tjera, por këtu ishte një nevojë për komunitetin ndërkombëtar, apo sido që quhet, me gjithë nevojën për të formuar shtetin. Për të formuar qeverinë dhe për t'u marrë me të gjitha çështjet njëherësh. Ishte një përvojë shumë e plotë.

Me një kënd disi të udhëhequr nga Amerika siç iu tregova, aty ku kam jetuar ka qenë shumë qejf, shumë komunitet sidomos të stilit sovjetik. Dhe shumë perspektiva të majta amerikane, sepse amerikanët e majtë shpesh janë disi ana e majtë e shpatës. Njëherë ne poashtu, me një përvojë ballkanase, për të qenë e sigurtë, njëherë me një mik timin ikëm në Greqi. Dhe mirë, nuk është shumë larg, Greqia dhe Maqedonia nuk janë shumë larg. Ikëm sepse ende kishte procedura, ishte goxha e sigurtë por kishte procedura ku duhej t'i tregonim dikujt. Ne vendosëm të shkojmë për dy ditë. Ishte fundjavë.

Kështu që ishte interesante sepse vozitja... ne gjithashtu po iknim në Mal të Zi, kjo është një pjesë tjetër... po mendoj jo ikje por kishte një autobus që shkonte në bregdetin malazez, i cili voziste për nëntë orë. Ishte... nëpër male. Përsëri, arrin tek një det i bukur dhe male të bukura. Fizikisht kalon nëpër një mal të lartë, mali që të çon në det. Dhe disi mendon rreth gjithë asaj për arsye se është... e dini ndoshta si ruse, mendon për shumë gjëra.

Mendon se ish-Jugosllavia nga perspektiva jonë, nga perspektiva ruse... më pyetët "Kur jam lindur?"

'60, '65, jam rritur në të '80-tat në një botë të mbyllur. Ish-Jugosllavia ishte një ëndërr e vogël. Ish-Jugosllavia ishte më e avancuara dhe më e afërta ndaj perëndimit. Kishte të gjitha gjërat që për Rusinë ishin të pabesueshme. Kishte sektor privat, nuk e di, kafiteri, restaurante dhe kishte mundësi të cilat nuk mund t'i imagjinoje, për shembull udhëtimin në perëndim për të fituar disa para dhe për t'u kthyer përsëri. Eh po, po kthehem tek e njëjta çështje por kishte shumë natyrë, shumë det dhe shumë male.

Dhe duke qenë se vij nga një familje me shumë mendime liberale dhe disi gjenerata e babait tim, prindërit e mi kanë bërë shumë *Perestroika*, të gjithë mendonin se Jugosllavia do të ishte më e lehta. Ata janë perëndimorë, ata tashmë janë perëndimorë... po flas për perspektivën ruse. Kështu që është më e lehtë... disi kur blloku sovjetik ra dhe shtetet perëndimore thjesht u bënë perëndimore dhe kaq. Ata tashmë kanë sektor privat, ata tashmë kanë... eh po disi ekonomi private. E dini, ata janë në perëndim, kanë lirinë e udhëtimit. Askush nuk e priste se do të përfundonte ashtu. Dhe tani... askush nuk do të mund ta priste fundin e tillë me shumë konflikte latente të pazgjidhshme ose vështirë të zgjidhshme.

Kështu që u bë disi i anasjelltë. Dhe më dukët se përvoja ndërkombëtare trevjeçare ishte shumë interesante, kur folëm për ndërkombëtarët që vinin e shkonin, çfarë jep e çfarë merrë. Natyrisht shumë njerëz rrijnë ose martohen, ose nuk e di, ia dedikojnë jetën e tyre Ballkanit. Ballkani të krijon varësi. Në rastin tim, unë u bëra e varur nga Ballkani por e dija se duhej të vendosja në kufi kohor sepse nuk e di. Për një arsye apo një tjetër, vendosa se do të qëndroja tri vjet. Sepse e dija që nëse do të rrija më shumë se tri vjet, me siguri do të rrija gjithë jetën time, ose do t'ia dedikoja gjithë jetën Ballkanit.

Dhe në një fazë të caktuar mora një vendim, "Jo, do të vazhdoj". E dua Ballkanin. Më pëlqen të kthehem. I dua njerëzit. E kuptoj këtë, e kuptoj këtë pjesë të historisë. Kam kaluar tri vite fantastike, interesante, mbase jo të lehta por tepër interesante në Ballkan por më është dashur të vendos një kufi kohor. Më mirë të kthehem, do të zhvendosem. Dhe u zhvendosa në një konflikt tjetër gjeopolitik falë Kombeve të Bashkuara, konflikt ky që ishte tërësisht i papritur për mua. Konflikt i panjohur. Shumë i rëndësishëm në të '90-tat, gati sikur Ballkani në të '20-tat. Përfundova në Guatemala në Amerikën Qendrore. Ky ishte një kapitull tjetër i jetës sime.

Anna Di Lellio: Çfarë ndodhi tutje? Pra u largove... na kthe në ditët e sotme. Çfarë keni bërë pas Ballkanit, pra Kosova, shkuat në Guatemala?

Seda Pumpyanskaya: Po, po.

Anna Di Lellio: Pastaj...

Seda Pumpyanskaya: Në rregull.

Anna Di Lellio: Ende je e angazhuar në Ballkan nga Këshilli i Evropës, apo?

Seda Pumpyanskaya: Po, në fakt jo...

Anna Di Lellio: ... indirekt...

Seda Pumpyanskaya: Indirekt, po mendoj, indirekt. Kjo është çështje tjetër. Do t'iu tregoj, por një çështje tjetër, nëse doni të flisni më shumë për ato përvoja, çkado qoftë, fëmijëria, Rusia, çfarëdo tjetër, Amerika, vetëm më bëj pyetje dhe unë do të... familja apo çkado... dhe do t'iu tregoj copëza të vogla. Eh po, siç thashë pas Ballkanit shkova në Guatemala ku kam kaluar tri vite të tjera, 2001-2004. Nuk mund të... shumë gjëra të përmbledhura në një fjalë, do të thosha komunikim rreth punës, imazheve, perceptimeve. Kështu që zbarkova aty, në shtetin për të cilin nuk dija asgjë. Nuk e dija fare se atje kishte pasur luftë civile e cila kishte zgjatur 36 vjet.

Në fakt ishte shumë më keq se për shembull në Salvador, ku konflikti ishte më i njohur, më shumë njerëz vdiqën dhe u zhdukën dhe unë gjithashtu nuk e dija se Kombet e Bashkuara kishin sjellur marrëveshjen e paqes vetëm në vitin '95, shumë vonë, kur e gjithë bota tashmë kishte ndryshuar. Kështu që ndihesha sikur nëse do të isha gjendur në mes të konfliktit gjeopolitik të shekullit XX në Ballkan... eh po ishte fundi i shekullit XX, fillimi i shekullit XXI... Unë disi... ishte disi sikur makinë e kohës e cila të dërgon në një konflikt që kishte qenë tepër i madh në të '80-tat por të gjithë e kanë harruar sot. Kështu funksionon bota dhe gjithçka. Por nuk ishte, nuk ishte më mirë.

Kjo ishte përvojë fantastike. Një përvojë tërësisht tjetër, është disi si një orhide e bukur në xhungël ose diçka e tillë me gjithë atë shije latino-amerikane. Krahasuar me Ballkanin, ishte konflikt tërësisht tjetër, por jo më i mirë. Përvojë tërësisht tjetër e Kombeve të Bashkuara sepse atje gjithçka ishte rreth të drejtave të njeriut, nuk ishte rreth policisë apo qeverisë, por të drejtave të njeriut. Kështu që, kënde të ndryshme. Dhe tërësisht kënde të ndryshme për shembull, për shembull... kur shkova atje, nuk e kuptova saktësisht se Guatemala ka mbi pesëdhjetë përqind njerëz indogjenë, 26 gjuhë, shumë ngjyrra të pasura dhe një system që... aparteidi ose racismi, sepse asgjë... nuk kishte asnjë ligj, asgjë nuk ishte e lidhur me të.

Qëndrova atje, jam e lumtur të tregoj më shumë. Vend dhe punë jashtëzakonisht interesante. Pas kësaj u zhvendosa në Evropë. Disi vendosa se ishte më interesante për mua që të marrë një perspektivë evropiane dhe u pranova në punë si Drejore e Komunikimit për Këshillin e Evropës, ku kam qenë për gjashtë vjet, nga viti 2006 deri në vitin 2011. Dhe ishte shumë interesante në një perspektivë tjetër sepse gjithçka ishte rreth çështjeve evropiane dhe marrëdhënieve të koordinimit multilateral, ishte rreth legjislacionit, me shumë gjëra të mira. Prapë po merresha me komunikim, zhvillim të komunikimit, operim të marrëdhënieve me publikun dhe informacion në përgjithësi, i cili filloi të zhvillohej shumë shpejt, pastaj nuk e di, angazhimi dhe kampanjat e informacionit publik zhvilloheshin shpejt, mediat sociale po zhvillohen shumë shpejt.

Kështu që të gjithë ishim të gllabëruar nga ky fakt, realisht po kërkonim të njëjtat detyra të cilat i kisha pasur kur kam shkuar në Bosnjë, si kërkojnë mjetet moderne të komunikimit, e dini, në një botë moderne. Por për të qenë e sigurtë, kishte një ndjenjë e cila në fakt ishte gjithmonë një lloj bisede... mendoj se do të ishte ndjenja e njëjtë sikur dikush të fliste për Afrikën sot... Kishte një botë të zhvilluar dhe disi një botë të pazhvilluar. Nuk janë terma të mirë, por ka shumë kontinente me shumë probleme. Por mund ta kuptosh dhe ndjesh këtë gjë vetëm kur shkon në këto vende. Dhe ne konsideroheshim si njerëz me përvojë në këtë fushë.

Quhet fushë për shkak të këtyre institucioneve, kur flasim për Kombet e Bashkuara, Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian, sepse është më shumë një punë teorike legislative në zyrat e tyre kryesore, me shumë më pak ndikim. I cili mendoj se sidoqoftë ishte një gjë shumë e madhe dhe pozitive në jetën reale, e cila, siç iu tregova, ne patëm mundësinë të shkojmë në vende si Bosnja, Kosova dhe Guatemala.

Pastaj kam bërë disa gjëra të tjera duke u marrë gjithmonë me komunikim. Vendosa të ndryshoj. Në fakt u ktheva në Rusi, e cila kishte ndryshuar shumë në ato njëzetë vjet, dhe kam punuar për një projekt tërësisht ndryshe. Duke ndërtuar një Qytet të Inovacionit dhe duke u marrë me inovacion, por gjithmonë përbrenda komunikimit. Kështu që puna ime ishte disi e ngjashme. Dhe kjo ka ndodhur në vitin 2001 dhe tani vazhdoj të punoj.

Lura Limani: 2011?

Seda Pumpyanskaya: 2011, më falni, në 2011. Kthimi në Rusi ishte poashtu interesant, të shohësh sa shumë ka ndryshuar në njëzetë vjet. Ndjenja... sepse natyrisht, pas njëzetë vjetësh kthehesh në një vend si Aleksandër Dumas, në njërin anë e njeh, por në anën tjetër nuk e njeh atë vend. Di si të lëvizësh, vozisësh, vjen në të njëjtin qytet, di si të reagosh ndaj disa gjërave, di si të parkohesh. Por ekzistojnë disa gjëra të caktuara, veçanërisht në ato vende të kufizuara të cilat më pëlqenin e të cilat kishin ndryshuar, ku kapë disi më pak. Ishte shumë interesante.

Pastaj formova firmën time personale. Një firmë të vogël që merrej me marrëdhënie me publikun. Gjithmonë me marrëdhënie me publikun dhe komunikim, kjo është ajo që jam duke bërë aktualisht. Dhe gjithashtu një gjë tjetër që doja t'i u tregoja, disi kam qenë duke menduar pse kam përfunduar me një karrierë ndërkombëtare kaq aventuriere, të cilan e dua shumë. Eh po, disi e përziej veten, por kam pasur biseda sot rreth migrimit të përzier, emigrimit, racizmit e të gjitha këtyre gjërave. Jam një përzierje e... mirë, unë jam e lindur në Moskë, jam rritur në Moskë, kam pasur gjithë këtë karrierë ndërkombëtare... jam bërë një njeri vërtetë kosmopolitan ndërkombëtar dhe mendoj se ndihem kështu.

Por jam gjithashtu përzierje, kam prapavijë armene. Emri im është armen, në fakt nga

Nagorno-Karabakh. Dhe pjesërisht hebreje, mbiemri im është hebrej. Kështu që mendoj se gjaku i këtyre kombeve disi determinon shumë. Dhe interesante, një gjë më pak e vërejtur në organizata si Kombet e Bashkuar ose Këshilli i Evropës, ato i kanë të metat e veta, kritikohen shumë... kanë shumë kufizime, por më pëlqejnë këto organizata. Mendoj se janë të nevojshme, mendoj... dhe më pëlqejnë kryesisht për shkak të idealistëve që punojnë aty dhe punojnë me shumë sinqeritet dhe provojnë t'i ndërrojnë gjërat.

Por e kam kuptuar që brenda tyre ka shumë njerrëz kosmpolitanë si unë, jo vetëm për shkak të edukimit apo gjuhëve, natyrisht njerëzit aty punësohen për shkak të aftësive gjuhësore, por kryesisht për shkak të përzierjes së gjakut. Dhe mendoj përzierje shumë të pazakonshme të, të... të gjithë që, mendoj se diçka e tillë të bën më të hapur. Kjo gjë të bën ndryshe. Dhe të bën të shohësh dy gjëra shumë të vendosura, në fakt tri gjëra: sensin e lirisë që e kisha në Shtetet e Bashkuara, për të cilin iu tregova; përzierjen e gjakut që më bën të ndryshme, të bën ndryshe për arsye se të bën më të vendosur në kuptimin e dallimeve; dhe jetesa në periudhën tranzicionale në Bashkimin Sovjetik, që po zhvillohet shumë shpejt.

Disi më pëlqejnë shtetet në tranzicion. Mendoj se është një prej gjërave më fascinuese. Tranzicionet janë të ndryshme. Janë irracionale dhe ndodhin për arsye të shumë rrethanave, por në tranzicione, papritmas të duhet të bësh çdo gjë. Duhet t'i zgjidhësh gjërat dhe kjo i bën ato me të vërtetë interesante.

Anna Di Lellio: A dëshiron të shtosh diçka ose a dëshiron të bësh ndonjë pyetje?

Lura Limani: Nuk kam nevojë...

Seda Pumpyanskaya: Po, ndonjë gjë që mungon, apo diçka më precize?

Lura Limani: Nuk mendoj se mungon diçka.

Anna Di Lellio: Jo, jo, vetëm nuk... a jetoni aktualisht në Moskë? A jetoni me prindërit tuaj, apo afër tyre, apo me... Moska?

Seda Pumpyanskaya: Po. Jam kthyer në Moskë. Jam kthyer në vitin 2011. Kam ardhur për shkak të kësaj pune për të cilën iu tregova, zëvendës-kryetare për marrëdhënie me publikun për shkollën e cila quhet fondacion dhe e cila synon rikrijimin e qytetit të inovacionit. Jam kthyer. Kam menduar të marrë një banesë me qira por u ktheva në të njëjtën banesë ku kisha qëndruar para se të largohesha në vitin '96. Është interesante kur hapë dollapet dhe i sheh të njëjtat letra të vogla... unë mbledh të gjitha letrat me shënimet e mia... ato po qëndronin aty. Kështu që, një fazë e caktuar e jetës tënde. Nuk kam pasur shumë, për shkak të qasjes time njëzetë vjet më pas, kur erdha në Shtetet e Bashkuara, njëzetë vjet më vonë për të studiuar në Universitetin e Harvardit.

Dhe papritmas i njeherë, zhurmat, nuk e di, disa piktura dhe disa gjëra. Kështu që, në të njëjtën mënyrë tashmë u ktheva në Moskë. Dhe për momentin jetoj pjesërisht në Paris, por për momentin kam qenë më shumë në Moskë sepse nëna ime ka qenë goxha e sëmurë, kështu që është dashur ta ndihmoja. Dhe kam kaluar shumë kohë, është një banesë afër banesës familjare në qendër të Moskës, ku kam jetuar gjatë viteve të '80-ta dhe '90-ta. Praktikisht, dy banesa por tepër afër. Kam kaluar shumë kohë në banesën e prindërve të mi e cila është ndoshta jo banesa e fëmijërisë time, por e rinisë time... Plot me objekte të njëjta, kujtime të njëjta, letrat e vogla.

Anna Di Lellio: Shkurtimisht je përfshirë edhe për t'i ndihmuar babait tënd për të nisur një revistë, apo?

Seda Pumpyanskaya: Jo...

Anna Di Lellio: Apo për të ruajtur të vjetrën, nuk më kujtohet saktësisht...

Seda Pumpyanskaya: Jo, po mendoj e kam ndihmuar shumë. Por atje, tregimi i babait tim, siç iu thashë ai ishte specialist në çështjet e Shteteve të Bashkuara. Unë kam qenë korrespondente e "Kosmoloskaya Pravda" e cila ishte një gazetë shumë liberale në atë kohë, në vitet '75, '76, me gjithë kulturën dhe me gjuhën e ashtuquajtur "zop" të shkrimit. Kështu që, disi gjëra të formuluar, jo në mënyrë direkte, por të kuptueshme. Pastaj për disa vite ai pati kohë të vështirë në Rusi, duke mos u publikuar, disi duke mos e lejuar, duke qenë i ndarë nga gjërat e nevojshme. Por ai është një njeri i fortë, kështu që mbijetoi. Pastaj dalë-ngadalë në një mënyrë disi byrokratike por racionale, ai po kthehej.

Ajo që unë e quaj byrokratike sepse në fakt ai ishte, kishte një trend të ri të vendosur, gazeta në gjuhën angleze. Kishte shumë publikime për "Kampin Sovjetik" të cilat publikoheshin në gjuhë të ndryshme. Jo vetëm anglisht, por edhe gjermanisht, spanjisht, e të tjerë. Po mendoj, Kuba dhe Gjermania Lindore, e të tjerë. Ishte disi si mjet i propagandës. Ekzistonte një gazetë e quajtur "Informacion nga Moska" dhe ai u propozua të punonte aty për shkak të anglishtes së tij të mirë dhe gjuhëve të tjera, ai ishte i supozuar të ishte kryeredaktor. Dhe kjo ishte e çuditshme. Ai ishte një publikim për të cilin askujt s'i interesonte. Por si gazetar i mirë, ai disi e shndërroi atë në një gazetë shumë të madhe.

Dhe më vonë erdhi një *Perestroika* dhe *Moscow News* [Lajme nga Moska] u bë disi si shtojcë e numrit një të *Perestroika*. E dini, kjo është një nga ato gjërat e çuditshme që ndodhën. Dhe më vonë, pra ai punoi në *Moscow News* dhe më vonë u zhvendos në një publikim tjetër, e cila ishte një revistë analitike *Novie Vremena* [Kohët e Reja], e cila ishte prapë e themeluar nga Stalini në nëntë gjuhë, në katërmbëdhjetë, sidoqoftë, nëntë më duket, si mjet i propagandës. Por me këto, e dini, *Perestroika* u bë një nga gazetatat më liberale analitike, dhe ai po punonte atje për një kohë. Në të '90-tat deri në të 2000-tat.

Ai poashtu pati një tregim të mirë me Shtetet e Bashkuara. Për dymbëdhjetë vjet ai nuk mundi të udhëtonte por pastaj u kthye në Shtetet e Bashkuara... mendoj se ishte... disi nëse u kthye në Rusi në vitin '76, ai u kthye pastaj në vitin '87 ose '88, dymbëdhjetë vjet më vonë në një mënyrë shumë të çuditshme, disi byrokratike sepse pati disa shkëmbime paqeje... për arsye se ishte një trend i ri në të '80-tat për të udhëtuar, dhe grupe njerëzish rrinin në shtëpi të ndryshme në shkëmbime, disi shkëmbime njerëzore. Shumë mirë. Ishte një udhëtim qesharak sepse ai fluturoi në aeroportin Johnn F. Kennedy, natyrisht duke ëndërruar shumë për New York-un dhe Manhattan-in, por grupi po shkonte në New Jersey. Kështu që, ata ishin të ulur në minibusë të vegjël me dritare shumë të ngushta.

Ai e pa qytetin e tij të dashur të New York-ut nga dritarja e ngushtë dhe u dërgua në Trenton të New Jersey-t, e cila nuk ishte ëndrra e tij. Por kjo u kthye në një marrëdhënie tepër të ngushtë me një mikeshë të mirë tonën, Patricia Compton, e cila ishte e angazhuar në qasjen puritane amerikane në këtë grup të shkëmbimeve, dhe u bë mike e ngushtë e jona. Dhe pastaj ai filloi të vinte. Po mendoj, karriera e tij kishte ndryshuar. Ai nuk po punonte tamam. Tani ai është duke shkruajtur një libër tjetër rreth letërsisë amerikane dhe karaktereve amerikane e gjërave amerikane.

Në vitin 2000, gjërat filluan të ndryshojnë duke qenë se revista ishte shumë liberale. Ishin tregimet që ata kishin ndërtuar, për fundin e Moskës i cili ishte i rrethuar dhe i kapur dhe revista kishte një kohë të vështirë, e atyre iu desh të largoheshin. Por kjo është një histori tërësisht tjetër dhe epokë tërësisht tjetër. Iu tregova që në Rusi njeriu sikur jeton njëqind vjet, kështu që është sikur një shekull tjetër i një formati tjetër të rregullave dhe ideve që erdhën në fuqi. Dhe praktika të tjera si presioni ekonomik në media dhe zaptimi i ndërtesave. Por kjo është një histori tjetër.

Anna Di Lellio: Faleminderit!

Lura Limani: Faleminderit shumë. Kjo ishte...

Anna Di Lellio: Faleminderit shumë. Poashtu edhe fundin, sepse nuk duam...